

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6054  
E shtunë, 4 korrik 2020  
çmimi 0.40 €

Familja e ish-presidentit  
Rugova beson në  
pafajësinë e Thaçit dhe  
të Veselit | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

KRYEMINISTRI I KOSOVËS, AVDULLAH HOTI, KA REALIZUAR VIZITËN  
E PARË ZYRTARE NË SHQIPËRI | FAQE 4-5

## KOSOVA DHE SHQIPËRIA PAJTOHEN PËR BASHKËPUNIM PRAKTIK



Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, dhe ai i Shqipërisë, Edi Rama, janë pajtuar që mbledhja e radhës ndërmjet dy qeverive të mbahet në pjesën e dytë të muajit shtator në Shkodër. Ata, gjithashtu, janë pajtuar për disa projekte ambicioze për të dy vendet që kanë të bëjnë me Doganën e Kosovës në Durrës, ndërtimin e një hidrocentrali dhe ndërtimin e një hekurudhe që lidh të dy vendet. Sipas tyre, ka ardhur koha që të kalohet në terma shumë praktikë të bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë

## Kërkohet kufizimi i numrit të zëvendësministrave në dy për ministri

Për një muaj qeveria Hoti ka emëruar 46 zëvendësministra në kuadër të 16 ministrave. Sipas Demokraci Plus, nga numri i përgjithshëm i zëvendësministrave të emëruar, vetëm shtatë janë gra apo 15 për qind dhe 39 burra apo 85 për qind. Kjo organizatë ka kërkuar që të mos emërohen më shumë se dy zëvendësministra për ministri. Edhe Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) ka kërkuar që të ketë përfaqësim të barabartë gjinor 50/50 në postet e zëvendësministrave. Projektligji për qeverinë parasheh të ketë tre zëvendëskryem-



ministra, 15 ministri, dy ministri në diskrecion të mandatarit, rreth 40 zëvendësministra, si dhe rreth 250 këshilltarë politikë | FAQE 3



Në QKUK po trajtohen 141 pacientë me Covid-19

### OPINION

OSMAN ZHITIA DJALË DHE BABA I MADH E BESNIK I IDEALEVE KOMBËTARE TË BABAIT SYLËS DHE TË BIRIT TË TIJ AFRIM ZHITISË | F. 13



Ismet SYLEJMANI

### MBYLLENI GJYKATËN SPECIALE! | F. 11

Nga Harry Bajraktari



### AKTUALE

ASHPËRSONET FUSHATA NË MAQEDONINË E VERIUT | F. 2

AFËR 42 MILIONË EURO KANË PAGUAR KOMUNAT SI PASOJË E VENDIMEVE GJYQËSORE GJATË TRE VJETËVE TË FUNDIT | F. 7

### EKONOMI

BANKAT KOMERCIALE PREZANTOJNË MUNDËSITË PËR QASJE NË FINANCA PËR BIZNESET E PREKURA NGA COVID-19 | F. 9

HAPET RRUGA PËR FILLIMIN E INVESTIMEVE NËPËR KOMUNA NË PROJEKTIN E EFIÇIENCËS SË ENERGJISË | F. 8

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A.  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

# Bajrami: Nuk ka buxhet për t'i bërë pagesat e dyta për punëtorët

Prishtinë, 3 korrik - Qeveria e Kosovës nuk ka mjete të mjaftueshme për ta zbatuar Pakon Emergjente Fiskale, pa rishikim të buxhetit i cili tashmë është dërguar në Kuvendin e Kosovës. Kështu ka thënë, në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", ministrja e Financave, Hykmete Bajrami. "Tani masat e Pakos Emergjente Fiskale janë pjesë integrale e Pakos për Rimëkëmbje Ekonomike. Kostoja e saj në fillim është parashikuar të jetë 160 milionë euro. Kjo kosto sa vjen e rritet për shkak të numrit të madh të aplikacioneve. Ne në Ministrinë e Financave, sipas llogaritjeve që kemi bërë, kostoja e Pakos Emergjente mund të shkojë deri në 180 milionë euro. Por, mund ta kalojë edhe këtë shumë. Prej kohës së lansimit e deri më tani janë disbursuar 80 milionë euro. Kemi arritur në limitet e shpenzimit të buxhetit që nënkupton, kemi mjaft pak mjete për të ekzekutuar edhe

disa vendime të komisioneve ndërmministrorë. Nëse nuk bëhet rishikimi i buxhetit të Kosovës, ne nuk mund të ekzekutojmë kërkesa", ka thënë ajo. Në Pakon Emergjente Fiskale, e cila është në vlerë rreth 180 milionë eurosh, ndër të tjera, është paraparë që punëtorët që kanë humbur vendin e punës, pas shpalljes së masave emergjente për shkak të pandemisë së koronavirusit, të përfitojnë nga 170 euro për dy muaj (prill dhe maj). Deri më tani është arritur të bëhet pagesa vetëm për një muaj. Nga Pakoja Fiskale deri më tani janë shpenzuar 80 milionë euro. Në dispozicion Kosova i ka rreth vetëm 1.5 milion euro për të disbursuar. Ndërkohë, Bajrami ka kërkuar nga deputetët e Kuvendit të Kosovës që t'i votojnë marrëveshjet ndërkombëtare për kredi, të arritura nga Qeveria e Kosovës, pasi këto marrëveshje ndihmojnë buxhetin e Kosovës.



Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave dhe Transfereve, totali i marrëveshjeve të cilat duhet

ratifikuar në procedurë të përshtetshme përfshinë pesë marrëveshje kredie në vlerë prej

228.1 milionë eurosh dhe dy marrëveshje bashkëfinancimi në vlerë prej 61 milionë eurosh.

## Ashpërsohet fushata në Maqedoninë e Veriut



SHKUP, 3 KORRIK - Fushata parazgjedhore në Maqedoninë e Veriut ka filluar të ashpërsohet, ndërsa nuk kanë munguar akuzat dhe ofendimet në mes të garuesve dhe gjuha e urrejtjes nëpër rrjetet sociale. Analistët thonë se votuesit dinë t'i vlerësojnë ofertat e mira teksa tërheqin vëmendjen për paralajmërimet për homologjizimin mbi baza

etnike të partive, pas zgjedhjeve kur do të formohet qeveria e re, që do të ishte rrezik për shtetin shumetnik. Zgjedhjet e parakohshme mbahen më 15 korrik. Retorika e garuesve në fushatën parazgjedhore në Maqedoninë e Veriut duket se po ashpërsohet, dy javë para zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Partitë maqedonase më tepër

hapësirë u kushtojnë arritjeve ose dështimit në raportet me fqinjët, identitetin e tyre etnik apo integritet euroatlantike, ndërsa ato shqiptare merren me statusin e gjuhës, përfaqësimin e drejtë në institucionet shtetërore dhe barazinë në aspektin etnik, teksa të gjithë premtojnë kushte më të mira ekonomike dhe financiare për votuesit.

Analisti Xhelal Neziri shikon një lloj nervozizmi te të gjitha partitë politike në fushatë, e cila ka zgjatur për muaj të tërë, ndonëse zyrtarisht u hap para dhjetë ditësh. Neziri thotë se kur kësaj i shtohen sondazhet të cilat i nxjerrin partitë garuese në pozicione të njëjta, i bën garuesit të jenë edhe më agresivë, në kuptimin e moszgjedhjes së mjeteve për të arritur sa më shumë vota. Bashkimi Demokratik për Integritet ka dalë me propozimin për kryeministrin e parë shqiptar duke kërkuar bashkimin e faktorëve dhe votuesve shqiptarë rreth kësaj ideje, por që është cilësuar si akt populist nga rivalët politikë maqedonas dhe shqiptarë, ndonëse nga ana tjetër si legjitim nga një pjesë e garuesve, juristëve dhe analistëve. Dy partitë më të mëdha maqedonase, Lidhja Social Demokrate dhe VMRO-DPMNE kanë theksuar se nuk pranojnë kushtëzime as shantazhe nga drejtues politikë shqiptarë, teksa kanë lënë të kuptohet se nuk

përshtojnë mundësinë që ta mbështesin me deputetë të tyre partinë fituese për ta formuar qeverinë. Analisti Neziri vlerëson se pas zgjedhjeve shumica parlamentare duhet të formojë një qeveri e cila duhet ta reflektojë vullnetin e të gjithë votuesve, duke marrë parasysh edhe diversitetet e paraqitura në fushatë. BDI-ja me garuesin e saj për kryeministër Naser Ziberi premtojnë se do të angazhohen që në të ardhmen vendimmarrjet që nga parlamenti e qeveria dhe institucionet e larta të shtetit deri tek ato vendore të bëhen me konsensus. Aleanca për shqiptarët dhe partia Alternativa të cilat janë në koalicion, po paraqiten në fushatë me një retorikë që le përshtypjen se synim kryesor kanë rrëzimin e BDI-së nga pushteti. Ato premtojnë ulje taksash, ngritje pagash dhe përmirësimin apo mundësimin e arsimimit të shqiptarëve në zonat ku janë në pakicë. (Voa)

## Specialja fton një ish-pjesëtar të UÇK-së

PRISHTINË, 3 KORRIK - Gjykata Speciale ka ftuar për intervistë ish-pjesëtarin e UÇK-së, Afrim Bytyqin. Lajmi është bërë me dije nga kryetari i Organizatës

së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Gucati. "Sapo u njoftova se është ftuar nga Gjykata Speciale veterani i luftës së UÇK-së, Afrim Bytyqi

nga Kishnica", ka shkruar Gucati në llogarinë e vet në "Facebook". Organizatat e dala nga lufta e UÇK-së dhe Shoqata e ish të Burgosurve Politikë e

Kosovës kanë bërë me dije se më 9 korrik në Prishtinë do të mbahet një protestë gjithëpopullore me moton "Në mbrojtje të luftës çlirimtare".



# Kërkohet kufizimi i numrit të zëvendësministrave në dy për ministri



Për një muaj qeveria Hoti ka emëruar 46 zëvendësministra në kuadër të 16 ministrive. Sipas Demokracia Plus, nga numri i përgjithshëm i zëvendësministrave të emëruar, vetëm shtatë janë gra apo 15 për qind dhe 39 burra apo 85 për qind. Kjo organizatë ka kërkuar që të mos emërohen më shumë se dy zëvendësministra për ministri. Edhe Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) ka kërkuar që të ketë përfaqësim të barabartë gjinor 50/50 në postet e zëvendësministrave. Projektligji për qeverinë parasheh të ketë tre zëvendëskryeministra, 15 ministri, dy ministri në diskrecion të mandatarit, rreth 40 zëvendësministra, si dhe rreth 250 këshilltarë politikë

**EPOKA ERE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 3 KORRIK - Demokracia Plus përmes një komunikate për media ka bërë me dije se të premtën janë është një muaj nga zgjedhja e qeverisë Hoti brenda së cilës periudhë janë emëruar 46 zëvendësministra në kuadër të 16 ministrive. "Numri i zëvendësministrave për ministri shkon nga një deri në pesë, por që ky numër pritet të rritet duke pasur parasysh që si proces nuk është përmbyllur ende. Nga numri i përgjithshëm i zëvendësministrave të emëruar, vetëm shtatë janë gra apo 15 për qind dhe 39 burra apo 85 për qind. Për më tepër, vendimet e qeverisë për emërimin e këtyre zëvendësministrave nuk janë publike si dhe emrat e tyre nuk janë publikuar në uebfaqet zyrtare të ministrive përkatëse", thuhet në komunikatën e Demokracia Plus. Sipas kësaj organizate, gjatë

periudhës së fushatës zgjedhore LDK-ja përmes kandidatës së saj për kryeministër ka nënshkruar Deklaratën e Zotimeve për Qeverisje të Mirë të hartuar nga Demokracia Plus. "Përmes kësaj deklarate, LDK-ja është zotuar në kufizimin e numrit të zëvendësministrave në maksimumi dy për ministri. Ky ka qenë edhe premtim elektoral, të cilin kërkojmë nga LDK-ja si udhëheqëse e qeverisë që t'i përmbahet. Kufizimi i numrit të zëvendësministrave, përveçse do t'i reduktojë shpenzimet financiare në këtë kohë të krizës ekonomike të shkaktuar nga pandemia Covid-19, besojmë se do të ndikojë edhe në rritje të efikasitetit të qeverisë, eliminimit të praktikës së punësimeve klienteliste dhe ruajtjes së integritetit të pozitës së zëvendësministrit e cila po devalvohet nga emërimet e personave të pakualifikuar dhe mbipopullimit", theksohet në

komunikatën e Demokracia Plus. Në këtë drejtim, Demokracia Plus ka kërkuar që: Të mos emërohen më shumë se dy zëvendësministra për ministri; Mos të ketë zëvendësministra nga subjekti politik i njëjti me ministrin; Të mos ketë zëvendësministra nga i njëjti subjekt politik brenda një ministrie; Zëvendësministrat të kenë portofol të caktuar; Zëvendësministrat të jenë persona me integritet të lartë profesional dhe moral; Të garantohet përfaqësim i barabartë gjinor për pozitën e zëvendësministrave; Të publikohen me kohë të gjitha vendimet për emërimet të zëvendësministrave; Të azhurnohen të gjitha uebfaqet e ministrive me emrat dhe të dhënat biografike për zëvendësministrat. Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) ka shprehur pakënaqësi dhe shqetësim lidhur me moszbatimin e Ligjit për Barazi

Gjinore (LBGj), me rastin e emërimit të zëvendësministrave nga qeveria e drejtuar nga kryeministri Avdullah Hoti. RrGK-ja ka kërkuar që të ketë përfaqësim të barabartë gjinor 50/50 në postet e zëvendësministrave. "RrGK me punën dhe aktivizmin e bërë që nga themelimi, përpiqet për një Kosovë ku gratë dhe burrat janë të barabartë dhe kanë mundësi të barabarta në arsimim, punësim, pjesëmarrje në politikë, shëndetësi, si dhe jetojnë një jetë pa dhunë. Prandaj, në përputhje të plotë me këtë vizion, RrGK përgjatë gjithë mandatit udhëheqës të kësaj qeverie do të kërkojë llogaridhënie publike dhe transparencë të plotë për punën e ekzekutivit që ndikon në realizimin e këtyre objektivave jetike për mirëqenien e të gjitha grave në Kosovë", thuhet në reagimin e RrGK-së. Zëvendëskryeministri i parë, Besnik Tahiri, para disa ditësh ka prezantuar Projektligjin për qeverinë, ku për tri javë do të jetë në diskutim publik, e më pas do të procedohet për votim në Qeveri dhe Kuvend. Ai u ka bërë thirrje Instituteve profesionale, ekspertëve e partive politike, shoqërisë civile e aktorëve qeverisës në të gjitha nivelet, që të japin ide e komente për këtë projektligj, i pari i këtij lloji në Republikën e Kosovës. "Ligji rregullon organizimin dhe funksionimin e qeverisë,

përcakton vija të qarta të llogaridhënies, kompetencave e të kufizimeve në të gjitha situatat, numrin e dikastereve, të ministrave, të zëvendësministrave, të emëruarve politikë e të stafit përcjellës", ka thënë Tahiri. Zëvendëskryeministri Tahiri ka thënë se Kosova sa më parë duhet ta ketë Ligjin për qeverinë në mënyrë që t'i përcaktojë një herë e përgjithmonë detyrat dhe kompetencat e qeverisë në kohë zgjedhesh, të qeverisë në detyrë ose të dorëhequr, në situatë të gjendjes së shpallur të jashtëzakonshme e kështu me radhë, pra që të mënjanohej situatat e paqarta e anomalitë me të cilat jemi përballur deri me tash për shkak të mungesës së këtij ligji. Projektligji për qeverinë parasheh të ketë tre zëvendëskryeministra, 15 ministri, dy ministri në diskrecion të mandatarit, rreth 40 zëvendësministra, si dhe rreth 250 këshilltarë politikë. Tahiri ka thënë se ky projektligj do të sjellë organizim dhe funksionim më të mirë të qeverisë. "Projektligji parasheh tre zëvendëskryeministra, 15 ministri, dy ministri në diskrecion të mandatarit. Rreth 40 zëvendësministra, rreth 250 këshilltarë politikë dhe nëpunës të kabineteve. Nuk ka ministra pa portofol. Ndalohet krijimi i trupave shtesë me funksione paralele", ka thënë Tahiri para mediave.

KRYEMINISTRI I KOSOVËS, AVDULLAH HOTI, KA REALIZUAR VIZITËN E PARË ZYRTARE NË SHQIPËRI

# KOSOVA DHE SHQIPËRIA PAJTOH



Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, dhe ai i Shqipërisë, Edi Rama, janë pajtuar që mbledhja e radhës ndërmjet dy qeverive të mbahet në pjesën e dytë të muajit shtator në Shkodër. Ata janë marrë vesh për disa projekte ambicioze për të dyja vendet që kanë të bëjnë me Doganën e Kosovës në Durrës, ndërtimin e një hidrocentrali dhe ndërtimin e një hekurudhe që lidh të dyja vendet. Sipas tyre, tani ka ardhur koha që të kalohet në terma shumë praktikë të bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë

zbatimin e disa marrëveshjeve kyçe ndërmjet dy vendeve. “Sot kemi folur për doganën e Kosovës në Durrës. Në parim është diçka e dakordësuar, por në zbatim është diçka jo e plotë. Ajo çka Hoti ka ngritur në bisedën e përbashkët, një stacion i vetëm në Durrës, ku hyrja e të gjitha mallrave për në Kosovë, nga pikëpamja legislative dhe juridike, duhet të trajtohet si një hyrje në Kosovë, në momentin kur mallrat zbarkohen në Durrës. Kemi folur për njësimin e dokumentacionit për mallrat që eksportohen/importohen mes dy vendeve, nëse nuk arrijmë që të dyja palët në nivelin teknik të kenë gjuhë të njësuar. Një dokument të jetë i vlefshëm për të dy vendet”, është shprehur Rama

Ndërsa kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka falënderuar kryeministrin Rama për vizitën që ka pasur ditë më parë në Prishtinë pas zhvillimeve të fundit lidhur me publikimin e akuzave të para të Gjykatës Speciale. “Kujdesi juaj që të vini menjëherë në Prishtinë pas atyre zhvillimeve është shumë

me vlerë. Ju falënderoj për pritjen miqësore dhe vëllazërore këtu. Tanimë është bërë një praktikë e bashkëpunimit tonë të mbledhjeve të përbashkëta të dy qeverive tona dhe unë besoj se tash duhet të kalojmë në terma shumë praktikë të bashkëpunimit tonë të përditshëm”, ka thënë Hoti. Ai ka theksuar se me

**EPOKA E RE**

Muhamet KOCI

**PRISHTINË, 3 KORRIK** - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, të premten ka realizuar vizitën e parë zyrtare në Shqipëri, ku është pritur me ceremoni shtetërore në Pallatin e Brigadave nga homologu i vet në Tiranë, Edi Rama. Të dy kryeministrat kanë diskutuar për mbledhjen e radhës ndërmjet dy qeverive dhe për projektet e tjera të rëndësishme për Kosovën dhe Shqipërinë.

Në konferencën e përbashkët për media, pas takimit, Rama dhe Hoti kanë treguar për

pajtimet që kanë bërë. “Jemi pajtuar për të përcaktuar, për të mbajtur në një afat të ri të mbledhjes së Shkodrës mes dy qeverive, me shpresën që situata jo e lehtë me Covid të na e mundësojë në gjysmën e dytë të shtatorit”, ka deklaruar kryeministri Edi Rama.

Ai ka përmendur edhe projektet e tjera me të cilat janë pajtuar me Hotin dhe të cilat kanë për qëllim mirëqenien për të dyja vendet. “Po ashtu, jemi pajtuar për një tjetër ngjarje të rëndësishme që do të zhvillohet për herë të parë mes nesh, gjithmonë me shpresë që situata me Covid do të na e mundësojë këtë në Tiranë në

muajin nëntor, ku dëshirojmë që bashkërisht ta sponsorizojmë kongresin e parë të autoriteteve vendore, i cili ne dëshirojmë të kthehet në një kongres tradicional, ku kryetarët e bashkive apo komunave, siç quhen në Kosovë, të mund t'i ndajnë praktikën e mira dhe sfidat e përbashkëta për adresimin e problemeve të përbashkëta, patjetër dhe potencialin e nismave të përbashkëta në fushën e mirëqeverisjes vendore”, është shprehur Rama. Më tej, Rama ka treguar se me homologun nga Kosova kanë diskutuar konkretisht për të gjithë elementët që lidhen me

# EN PËR BASHKËPUNIM PRAKTIK



Diskutuam për ndërtimin e një HEC-i në Shqipëri, për ta furnizuar Kosovën me energji. Diskutuam edhe për projektin ambicioz për hekurudhën që lidh Tiranën dhe Prishtinën”, ka deklaruar Hoti.

## Kosova e gatshme për ta caktuar datën e takimit të Uashingtonit

Përveç çështjeve që kanë të bëjnë me të dy vendet, kryeministri i Kosovës dhe i Shqipërisë kanë folur edhe për dialogun Kosovë - Serbi, i cili pritet të fillojë së shpejti. Kryeministri Hoti ka deklaruar se institucionet e Kosovës janë të gatshme për rifillimin e procesit të dialogut Kosovë - Serbi. Ai ka thënë se është gati të flasë me emisarin special të ShBA-së për dialogun, Richard Grenell, për caktimin e datës për takimin e Uashingtonit. “Kosova ka institucione legjitime kushtetuese të gatshme të marrin të gjitha përgjegjësitë. Unë jam i gatshëm dhe në koordinim me Grenellin për të caktuar një datë për dialogun, me një agjendë fillimisht ekonomike e më pas politike, për njohje reciproke dhe normalizim të raporteve mes dy vendeve”, ka deklaruar Hoti.

Kurse kryeministri Rama ka thënë se në këtë proces Shqipëria do të jetë gjithmonë në krah të Kosovës. “Nëse ne jemi një, presidenti i Serbisë mund të shkojë edhe në Hënë, por në fund do të ulet me ne, autoritetet e shtetit sovran të Kosovës, që e njeh apo nuk e njeh ai, është sovran dhe i paprekshëm në sovranitetin e vet dhe me ne në Tiranë, që do ta mbështesim deri në fund Prishtinën”, është shprehur ai, duke shtuar se në këtë drejtim

janë vetëm dy rrugë, barrikadimi dhe përballimi. “Barrikadimi është në dëmin tonë, jo në dëm të Serbisë. Përballimi sy me sy dhe drejtpërdrejt me mjetet e paqes, është sfida jonë. Fiton kush është më i mençur dhe të tregojë forcën e mendjen dhe të largpamësisë. Nuk fiton kush bën të fortin me ‘Facebook’ apo deklarata përçarëse duke shfrytëzuar emocione apo konjuktura të brendshme që po shpëton atdheun nga tradhtarët. Duhet të bësh çmos për të bërë

mbetur pa liberalizim të vizave dhe që mbetet shteti i vetëm në rajon që nuk lëviz lirshëm në vendet e zonës shengen. Sipas tij, kjo po ndodh për shkak të kalkulimeve politikave të brendshme të Evropës. “Turp i Bashkimit Evropian që mban peng një popull dhe ende e ndalon të lëvizë lirshëm si gjithë të tjerët pasi si shtet i ka plotësuar të gjitha detyrimet. E dimë shumë mirë arsyen se përse. Arsyeja nuk gjendet në Kosovë. Nuk gjendet në ndonjë

tij, kjo nismë hap përfundimisht mundësinë për heqjen e kufirit në mes të Shqipërisë dhe Kosovës. “Shengeni rajonal mbetet në këndvështrimin tim një program ku shqiptarët duhet ta shohin bashkërisht interesin e tyre strategjik. Besoj se është e qartë. Në rast se ne futemi bashkërisht në shengenin rajonal, askush nuk na pengon që në kohë të shpejtë ta hapim kufirin për lëvizjen e lirë të njerëzve pa asnjë kontroll”, ka deklaruar Rama.



paqe, jo për fqinjët, por për të ardhmen. Nuk mund të presim që Vuçiçi të deklarojë se do ta njohë pavarësinë e Kosovës”, ka deklaruar Rama.

## Kritika BE-së për mosliberalizim të vizave për Kosovën

Kryeministri Edi Rama e ka cilësuar turp për Bashkimin Evropian faktin se Kosova ka

paafësi të saj për përmbushjen e detyrimeve. Ato janë përmbushur. Arsyeja është në Evropë, në politikën e brendshme, në vendet e ndryshme që gjithmonë e më shumë, kur marrin vendime për ne, nisen nga kalkulimet për qëndrueshmërinë elektorale të forcave politike që qeverisin”, ka thënë Rama.

Ai ka thënë se me kryeministrin Hoti ka folur edhe për idenë e minishengenit ballkanik. Sipas

Vizita e kryeministrit të Kosovës në Shqipëri pason pas vizitës dyditore të kryeministrit të Shqipërisë në Kosovë. Gjatë ditës Hoti ka takuar edhe presidentin e Shqipërisë, Ilir Meta, kryetarin e Kuvendit, Gramoz Ruçi, kryetarin e Partisë Demokratike, Lulzim Basha, si dhe kryetarin e Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj. Gjatë këtij takimi, Veliaj ia ka dhuruar Hotit “Çelësin e Qytetit të Tiranës”.



kryeministrin Rama janë pajtuar për disa projekte, që ai i quajti ambicioze, dhe që kanë të bëjnë me Doganën e Kosovës në Durrës, ndërtimin e një HEC-i dhe ndërtimin e një hekurudhe që lidh të dy vendet. “Me kryeministrin Rama u pajtuam për tri projekte ambicioze. Një ndër pikat që u pajtuam ishte çështja e Doganës së Kosovës në Durrës.

## Familja e ish-presidentit Rugova beson në pafajësinë e Thaçit dhe të Veselit

PRISHTINË, 3 KORRIK (ER) - Familja e ish-presidentit të Kosovës, Ibrahim Rugova, ka reaguar për ngritjen e aktakuzës nga Prokuroria e Specializuar ndaj presidentit Hashim Thaçi dhe kryetarit të PDK-së, Kadri Veseli.

Nga kjo familje kanë kujtuar disa fjalë të rëndësishme të Rugovës lidhur me krimet e luftës në Kosovë. "Kam punuar dhe kam besuar për zgjidhje paqësore (të çështjes së Kosovës) për më shumë se dhjetë vjet, por pastaj është shfaqur opsioni tjetër, në mungesë të rezultateve. UÇK-ja, siç kam theksuar, erdhi në shprehje si përgjigje ndaj dhunës së ushtruar në Kosovë për një periudhë të gjatë. Kjo ka qenë një organizatë e përbërë nga qytetarët që iu përgjigjën dhunës me qëllimin e fitimit të lirisë së popullit. Ky ishte synimi i tyre", kishte thënë Rugova. "Presidenti Rugova në dëshminë e tij në Tribunalin e Hagës ka dhënë shpjegimin e tij të jashtëzakonshëm politik të

rrjedhës historike në Kosovën e viteve nëntëdhjetë, duke zbardhur në mënyrën më të qartë të mundshme kush ka qenë agresor dhe okupator dhe kush ka qenë viktimë në Kosovë. Këto rrjedha historike kulmuan në vitet 1998, 1999, me luftën e UÇK-së, të popullit të Kosovës dhe të miqve tanë të mëdhenj, ShBA-së dhe shteteve të Aleancës Veri-Atlantike, për çlirimin e Kosovës", theksohet në deklaratën e familjes Rugova.

Në këtë deklaratë, theksohet se ish-presidenti Rugova ka pasur një bashkëpunim shumë të veçantë me Hashim Thaçin në kuadër të delegacionit të Kosovës në Konferencën Paqësore të Rambujesë. "Vetëm një unitet i këtillë politik në kuadër të Lëvizjes për pavarësinë e Kosovës ka mundur ta sjellë Marrëveshjen e Rambouilletit, pa të cilën Kosova nuk do të çlirohej kurrë. Presidenti Rugova edhe pas luftës, në kuadër të ndërtimit të institucioneve demokratike të



Kosovës, ka insistuar në kultivimin e bashkëpunimit politik, veçmas kur bëhej fjalë për temat për interes madhor të vendit, siç ishte edhe Procesi i Vjenës për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Edhe këtu presidenti Rugova dhe Hashim Thaçi, atëherë si kryetar i PDK-së, kanë qenë së bashku, në kuadër të Ekipit të Unitetit, me synim të arritjes së pavarësisë së Kosovës", thuhet në këtë deklaratë.

Familja e ish-presidentit Rugova beson në pafajësinë e presidentit Thaçi dhe ish-kryetarit të Kuvendit, Kadri Veseli. "Si familje e presidentit historik të Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova, jemi të bindur që historia e lavdishme e Kosovës e viteve nëntëdhjetë e cila solli çlirimin e Kosovës dhe, më pas, edhe pavarësinë e saj, ka shfaqur vlerat më të larta të popullit të Kosovës dhe ka bërë bashkë Kosovën me ShBA-në

dhe me Evropën. Këtë histori askush dhe asgjë nuk mund ta ndryshojë. Në këtë kontekst, ne besojmë në pafajësinë e presidentit Thaçi dhe ish-kryetarit të Kuvendit, Kadri Veseli. Zoti e bekoftë shtetin e Kosovës! Zoti e bekoftë miqësinë e përjetshme të Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës!", theksohet, ndër të tjera, në deklaratën e familjes së ish-presidentit Rugova.

## Mbahet takimi i BE-së kundër trafikimit të armëve të vogla dhe të lehta në Ballkanin Perëndimor

**EPOKA E RE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 3 KORRIK - Anëtari i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Prokurori Zejnullah Gashi, së bashku me përfaqësues të Policisë së Kosovës, po merr pjesë në takimin e tretë rajonal kundër trafikimit të armëve të vogla dhe të lehta në Ballkanin Perëndimor, eveniment ky i radhës, i cili është organizuar përmes komunikimit në distancë nga Bashkimi Evropian (BE).

Qëllimi i mbajtjes së këtij takimi të rëndësishëm evropian është zbatimi i vazhdueshëm i udhëzuesit për zgjidhje të qëndrueshme lidhur me



mbajtjen e paligjshme, keqpërdorimin dhe trafikimin e armëve të vogla dhe të lehta dhe municioneve të tyre në Ballkanin Perëndimor deri në vitin 2024.

Në sesionet e tij po marrin pjesë përfaqësues të BE-së, Këshillit

për Bashkëpunim Rajonal dhe ministrive të punëve të brendshme të shteteve të Evropës Juglindore dhe Lindore, si dhe përfaqësues të sistemeve të drejtësisë, të cilët kanë raportuar për zbatimin e këtij udhëzuesi në vendet e tyre.

Në këtë kontekst, anëtari i KPK-së, Zejnullah Gashi, do të raportojë para pjesëmarrësve për trajtimin nga prokuroritë e Kosovës të veprave penale të mbajtjes së paligjshme dhe trafikimit të armëve, me fokus të veçantë për rëndësinë e mekanizmit përcjellës për veprat penale karakteristike, përfshirë këtu pashmangshëm edhe armët e vogla dhe të lehta, si dhe përshtatjen e këtij udhëzuesi me juridiksionin e shtetit të Kosovës.

Rrjedhimisht, në të gjitha sesionet e forumit deri tashti janë diskutuar progresi, sfidat dhe nevojat e vendeve pjesëmarrëse, si dhe është bërë prezantimi i planit të veprimit të këtyre vendeve që veprojnë në kuadër të

këtij projekti, përfshirë përparimin në qëllimet e përcaktuara dhe nevojat e identifikuar.

Po ashtu, pjesëmarrësit janë pajtuar që mekanizmat kombëtarë dhe ndërkombëtarë të angazhohen fuqishëm për të siguruar një mbështetje të planifikuar për zbatimin e këtij udhëzuesi, ta monitorojnë implementimin e gjetjeve rajonale dhe ta bëjnë prezantimin e vazhdueshëm të treguesve kryesorë të performancës.

Me anë të këtij projekti, BE-ja synon ta eliminojë qarkullimin e paligjshëm të armëve të kalibrit të vogël në rajonin e Ballkanit Perëndimor, në mënyrë që të krijohet një siguri më e lartë në nivelin evropian.

## Qytetarët nga Kosova që shkojnë në Zvicër duhet të vetizolohen

PRISHTINË, 3 KORRIK - Nga data 6 korrik qytetarët e 29 vendeve që shkojnë në Zvicër duhet të lajmërohen tek autoritetet dhe të vetizolohen si masë për parandalimin e përhapjes së koronavirusit. Lista e vendeve me rrezik të lartë infeksioni përfshin edhe Kosovën.

Një njoftimin e qeverisë zvicerane, të publikuar të

enjtën, thuhet se "vizitorët që kanë kaluar kohë në vendet e emëruara gjatë 14 ditëve të mëparshme, duhet t'i njoftojnë autoritetet zvicerane menjëherë pas mbërritjes dhe më pas të futen në karantinë për 10 ditë".

Lista e vendeve të prekura përfshin gjithashtu Serbinë, Suedinë, Shtetet e Bashkuara, Brazilin e të tjera.

Lista do të rishikohet vazhdimisht, ka njoftuar qeveria zvicerane.

Në Zvicër numri i të infektuarve me koronavirus ka filluar të rritet në javët e fundit, por kufijtë e saj me Italinë, Austrinë, Gjermaninë dhe Francën mbeten të hapur. Zvicra ka konfirmuar 32 000 raste me koronavirus dhe 1 686 viktima.



# Afër 42 milionë euro kanë paguar komunitat si pasojë e vendimeve gjyqësore gjatë tre vjetëve të fundit

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 KORRIK - Lëvizja FOL ka mbajtur të premtën konferencë për media, me ç'rast ka publikuar raportin "Pagesat e vendimeve gjyqësore nga komunitat - vitet 2017, 2018, 2019".

FOL me mbështetjen e grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë përgjatë një viti ka bërë monitorimin e pagesave nga 38 komuna të Republikës së Kosovës si rezultat i vendimeve të gjykatave.

Elbasan Racaj nga Lëvizja FOL ka thënë se periudha e monitorimit të këtyre pagesave ka përfshirë vitet 2017, 2018 dhe 2019. "Të dhënat mbi pagesat e komunave për vitet 2017 dhe 2018 janë marrë nga raportet financiare të komunave dhe nga raportet e Zyrës së Auditorit dhe janë bazuar në përgjigjen e komunave ndaj kërkesave për qasje në dokumente publike", është shprehur Racaj.

Përveç monitorimit të këtyre shpenzimeve, FOL ka bërë edhe krahasimin me buxhetet fillestare të komunave.

Gjetjet nga ky monitorim tregojnë se vetëm gjatë vitit 2019 komunitat kanë pasur 3115 lëndë në gjykata si rezultat i të cilave kanë paguar 15 966 933.45 euro. Gjatë vitit 2019 pagesa janë bërë nga pesë kategori ekonomike: 1. Investimet kapitale; 2. Mallrat dhe shërbimet; 3. Shpenzimet komunale; 4. Paga dhe mëditje; dhe 5. Subvencione dhe transferime.

Pagesat më të larta gjatë këtij viti kanë ndodhur nga kategoria ekonomike e investimeve kapitale në shumën prej 10 588 554.82 euro, me kategorinë ekonomike të mallrave dhe shërbimeve nga ku janë paguar 4 033 909.66 euro dhe në kategorinë ekonomike të shpenzimeve komunale nga ku janë paguar 865 906.06 euro.

Pagesat më të ulëta kanë ndodhur nga kategoria ekonomike e pagave dhe mëditjeve në shumën prej 397 334.55 euro, kurse nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve ka pasur pagesa prej 81 228.36 eurosh. "Gjatë vitit fiskal 2017 komunitat kanë paguar shumën prej 9 565 608.55 eurosh apo 2.12 për qind të buxheteve të



tyre fillestare. E njëjta shumë e paguar, kur e krahasojmë me realizimin e të hyrave vetjake të të gjitha komunave për vitin 2017, arrin në 12.24 për qind. Ndërkaq, gjatë vitit 2018 komunitat kanë paguar gjithsej

shumën prej 16 425 330.43 eurosh apo 3.29 për qind të buxheteve të tyre fillestare. Krahasuar me të hyrat vetjake për vitin 2018, shuma e paguar nga komunitat si rezultat i vendimeve të gjykatave arrin në

20.20 për qind", ka deklaruar Racaj, duke shtuar se pagat jubilarë dhe mospërbushja e kontratave janë ndër shkaktarët kryesorë të këtyre miliona eurove që komunitat humbin si pasojë e vendimeve të gjykatave.

## Në QKUK po trajtohen 141 pacientë me Covid-19



PRISHTINË, 3 KORRIK (ER) - Qendra Klinike Universitare e Kosovës ka njoftuar se në repartet e saj janë të shtrirë 141 pacientë me sëmundjen Covid-19. "Në Klinikën Infektive janë të shtrirë 112 raste me Covid-19, në pulmologji 20 pacientë, kurse në mjekësinë sportive, njësia intensive, janë të shtrirë 9 pacientë", thuhet në njoftimin për media.

Në Klinikën Infektive 58 raste janë duke u trajtuar me oksigjenoterapi dhe përkujdesje intensive. "Prej tyre, 2 raste janë

në gjendje të rëndë duke u trajtuar me oksigjenoterapi dhe përkujdesje intensive, 4 raste janë në gjendje kritike me frymëmarrje të asistuar me respirator", thuhet në njoftim. Nga Klinika Infektive janë lëshuar 5 pacientë, 3 prej të cilëve me Covid-19, por me gjendje stabile klinike dhe 2 të shëruar nga sëmundja. Në bazë të të dhënave të fundit, numri i përgjithshëm i të infektuarve në Kosovë ka shkuar në 3 064. Prej tyre, 55 pacientë kanë vdekur dhe 1 707 janë shëruar.

## Osmani falënderon Japoninë për ndihmat në përballimin e pandemisë

PRISHTINË, 3 KORRIK (ER) - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, në takim me të ngarkuarin me punë të Ambasadës së Japonisë, Mitsunori Ogasawara, ka thënë të premtën se ndihma e Japonisë për t'i përballuar pasojat e pandemisë Covid-19 është e çmueshme dhe ka ardhur në kohën e duhur. Ajo ka falën-

deruar shtetin japonez për ndihmat dhe ka thënë se bashkëpunimi në luftën kundër pandemisë duhet të jetë prioritet. "Është mirë që kemi mbështetjen e një shteti mik si Japonia në këto kohë të vështira", ka thënë Osmani, duke kërkuar që bashkëpunimi në këtë sferë të vazhdojë edhe më.

Në këtë takim u diskutua edhe

për mundësitë e investimeve në infrastrukturën shëndetësore me qëllim që të krijohen kapacitete të duhura për preventivë, përtej reagimit emergjent.

Palët diskutuan edhe për mundësitë e shkëmbimit ndërmjet të dy shteteve si në fushën e digjitalizimit apo teknologjisë, me fokus të posaçëm në burimet e ripërtëritshme të energjisë.



# Hapet rruga për fillimin e investimeve nëpër komuna në projektin e efijencës së energjisë



**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 3 KORRIK** - Në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit (MEA) të premtën është nënshkruar marrëveshja në mes të Agjencisë së Kosovës për Efijencë të Energjisë dhe Fondit të Kosovës për Efijencë të Energjisë.

Në ceremoninë e nënshkrimit i pranishëm ishte edhe ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi. Efijenca e energjisë konsiderohet nga Qeveria e Kosovës një komponentë thelbësore e planifikimit strategjik dhe ekonomik si dhe për zhvillimin e

Kosovës, prandaj është përcaktuar të kontribuojë drejt arritjes së caqeve për EE, duke krijuar për qytetarët stimuj në kursimin e energjisë, por edhe për tregjet e hapura dhe aplikimin e bizneseve të reja për EE teknologjitë.

Si palë nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe si nënshkruese e marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), Kosova është obliguar që t'i transpozojë dhe zbatojë Acquis Communautairei që ndërlihen me efijencën e energjisë. Republika e Kosovës dhe institucionet e saj përgjegjëse në fushën e EE kanë shprehur vullnetin e tyre drejt

përbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë.

Tanimë është funksionalizuar Fondi i Kosovës për Efijencë të Energjisë sipas ligjit për Efijencë të Energjisë. Kosova është shteti i parë në rajon që themelon një mekanizëm financiar për masat e efijencës së energjisë në të gjithë sektorët e konsumit të energjisë.

Me ratifikimin e marrëveshjes të datës 15 janar 2015 ndërmjet Republikës së Kosovës (Pranuesi) dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim në vlerë 31 milionë dollarë, me zbatimin e suksesshëm të Projektit të Kosovës për Efijencë

të Energjisë dhe Burime të Rinovueshme (PKEEER), Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit përmes Agjencisë së Kosovës për Efijencë të Energjisë ka shprehur gatishmërinë që pakon e fundit për komunat ta zbatojë përmes Fondit të Kosovës për Efijencë të Energjisë përmes kësaj marrëveshje, vlera e së cilës është 5 milionë euro.

Me qëllim për ta zgjeruar fushën e programit në bazë më të qëndrueshme me krijimin e Fondit të Kosovës për Efijencë të Energjisë ristrukturimi i PKEEER do të ketë financim shtesë që do të kanalizojnë 10.37 milionë dollarë amerikanë në

fondet e grantit të Instrumentit të BE-së për Para-Anëtarësim (IPA II) prej 9.6 milionë eurosh në fushën e efijencës së energjisë.

Nga ky fond do të përfitojnë të gjitha komunat e Kosovës, në sektorin e Arsimit, Shëndetësisë, Administrativ dhe të tjerë sektorë. Më e rëndësishmja është se do të krijojë një strukturë të përhershme institucionale si mekanizëm financiar që mund të vazhdojë me renovimin e ndërtesave publike dhe përfundimisht të zgjerohet në sektorin rezident si, p. sh., blloqe apartamentesh dhe shtëpi individuale, si dhe do të zgjerohet edhe në sektorin privat të bizneseve.

## Reçica: Me avancimin e mekanizmave ligjorë jetësojmë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara

**PRISHTINË, 3 KORRIK (ER)** - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, të premtën ka pritur në takim përfaqësuesit e Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara Handikos, të prirë nga Afrim Maliqi, me të cilët ka diskutuar për situatën në të cilën është kjo kategori e shoqërisë sonë, veçmas pas përhapjes së pandemisë.

Ministri Reçica ka theksuar se në bashkëpunim edhe me donatorët do t'i shqyrtojmë mundësitë për krijimin e një platforme përmes së cilës do të mund të përfshihen personat me aftësi të kufizuara në programet e aftësisë dhe

riaftësisë profesionale, gjithnjë mbi bazën e nevojave të tregut të punës dhe nevojave të personave me aftësi të kufizuara.

Ministri Reçica i ka siguruar përfaqësuesit e Handikosit se do të angazhohet edhe gjatë këtij mandati për realizimin e prioriteteve me interes të përbashkët, duke përfshirë planin legjislativ, avancimin e mekanizmave ligjorë në funksion të jetësisë të të drejtave të plota të personave me aftësi të kufizuara, duke përfshirë këtu edhe punësimin e tyre nëpër institucionet shtetërore.





# Bankat komerciale prezantojnë mundësitë për qasje në financa për bizneset e prekura nga Covid-19

Përfaqësuesit e bankave komerciale kanë prezantuar ofertat dhe produktet e tyre aktuale përmes të cilave synojnë t'i ndihmojnë bizneset që ta përballojnë më lehtë krizën e shkaktuar si pasojë e masave kufizuese për parandalim të pandemisë Covid-19

reja pas përfundimit të pandemisë.

Milazim Abazi, kryesues i Komitetit të Financave të Odës Ekonomike Amerikane, duke folur mbi problemet e shumta të bizneseve në këtë kohë, me theks të veçantë tek ato me likuiditet, ka theksuar se për sektorin privat është jetike të ofrohet mbështetje shtesë nga ana e bankave komerciale përtej masave të dakorduara në bashkëpunim me Bankën Qendrore për shtyrje të kësteve. Sipas Abazit, në harmoni me mundësitë e bankave, bizneset në vend kanë nevojë për qasje më të lehtë në financa që ta vazhdojnë operimin e tyre në mënyrë normale.

Adonis Bllacaku, kryesues i Departamentit të Biznesit në

Bankën për Biznes, ka theksuar se kjo bankë ka krijuar pako specifike për ta lehtësuar qasjen në financa për mikrobiznese, grup ky i cili është në fokus për mbështetje nga ana e kësaj banke. Ai ka thënë se me synim për ta vazhduar përkrahjen ndaj bizneseve, BPB-ja ka aprovuar limite të reja deri në 30 përqind të limitit të zakonshëm për klientët ekzistues, duke u mundësuar kështu

ndërmarrjeve qasje në fonde shtesë për zhvillim të veprimtarive dhe rifillim të aktiviteteve të tyre.

Sipas Bllacakut, kjo përqindje e fondeve shtesë nuk ka qenë përfundimtare dhe banka është e hapur ndaj mundësive të tjera, ndërsa rekomandimet specifike nga bizneset janë

shumë të mirëseardhura për zhvillim të mëtutjeshëm të produkteve.

Lulzim Tahiri, menaxher i Departamentit për Bankim të NVM-ve në bankën TEB, ka thënë se edhe gjatë kësaj kohe nuk ka pasur ndërprerje të proceseve të kreditimit brenda bankës, kurse janë ofruar edhe shtesa në linjat kreditore të klientëve ekzistues të bankës TEB.

Tahiri u shpreh se si rezultat i krizës së shkaktuar nga pandemia Covid-19, banka TEB përtej shtyrjes së kredive ka ndarë edhe fonde të veçanta për kredi të dedikuara në mbështetje të bizneseve për mbulim të pagave dhe kostove të tjera operacionale, si dhe për furnizim varësisht nga lloji i biznesit. Sipas Tahirit, të gjitha masat mbështetëse janë marrë në përputhje me rekomandimet e Bankës Qendrore të Kosovës.


Armend Haxhiu, kryesues i Departamentit të Biznesit në "ProCredit Bank", ka potencuar se as kjo bankë nuk i ka ndaluar proceset e kreditimit, derisa ka ofruar shtyrje të pagesave të kredive për klientët në vështirësi financiare konform me rekomandimet e BQK-së. Haxhiu, po ashtu, ka thënë se si rrjedhojë e vështirësive të ndryshme të krijuara nga pandemia, ProCredit ka lidhur marrëveshje me institucione financiare ndërkombëtare, të cilët kanë ofruar linja kreditore për mbështetje të mëtutjeshme të bizneseve të Kosovës.

Ai ka theksuar se banka ProCredit në partneritet me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ka krijuar një ofertë për ta mbështetur investimin në platforma elektronike për ta lehtësuar zhvillimin e shitjeve online, i cili është dëshmuar të jetë shumë i nevojshëm sidomos gjatë kësaj periudhe.

EPOKA  
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 3 KORRIK - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka organizuar një konferencë virtuale mbi qasjen në financa për biznese, marrë parasysh pasiguritë e mëdha financiare të kësaj kohe. Gjatë kësaj konference përfaqësuesit e bankave komerciale patën

mundësinë t'i prezantojnë ofertat dhe produktet e tyre aktuale përmes të cilave synojnë t'i ndihmojnë bizneset që ta përballojnë më lehtë krizën e shkaktuar si pasojë e masave kufizuese për parandalim të pandemisë Covid-19, por edhe ta lehtësojnë qasjen në financa për ndërmarrjet që mund të kenë nevojë për investime të



## Tejkaloheh projeksioni i të hyrave edhe për muajin qershor

PRISHTINË, 3 KORRIK (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka bërë me dije se rikthimi në normalitet i deklarimit dhe pagesës së tatimeve ka reflektuar edhe në muajin qershor. "Rikthimi në normalitet i deklarimit dhe pagesës së tatimeve ka reflektuar edhe në muajin qershor, për të cilin vërehet rritje e dukshme e të hyrave në

raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, si dhe në raport me muajit paraprak. Shuma e inkasuar për janar-qershor 2020 është 215.9 milionë euro, ku diferenca e rritjes është në muajin maj dhe qershor, pas vështirësive të krijuara nga pandemia për periudhën e muajve mars dhe prill, të hyrat e mbledhura vetëm në muajin qershor janë në vlerë 29,8

milionë euro, 5.7 për qind ose 1.6 milion euro më shumë se plani i paraparë. Ndërsa në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (qershor 2019), kemi rritje për 13.6 për qind apo 3.5 milionë euro më shumë. ATK-ja do të punojë në vazhdimësi që të realizohen objektivat e parapara për këtë vit", është thënë në njoftimin e ATK-së.



## Nënshkruhet marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Komunës së Mitrovicës dhe Infrakosit

MITROVICË, 3 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka pritur të premten në një takim ushtruesin e detyrës së kryeshëfit ekzekutiv të Infrakosit, Xhevat Ramosaj, drejtorin e Departamentit të Financave, Zymer Zekaj, dhe drejtorin e Pronës, Rrahim Tërnavë, me ç'rast kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në mes të dy institucioneve.

Në këtë takim ishin të pranishëm edhe drejtori për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë, Naser Muja, drejtori për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Hysen Muzliukaj dhe drejtori për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, Besnik Beka. Përmes marrëveshjes së nënshkruar nga Komuna e Mitrovicës dhe Infrakosi është arritur bashkëpunimi në këto fusha siç janë: riorganizimi i aspekteve

të sigurisë hekurudhore brenda qytetit të Mitrovicës dhe rregullimi ligjor i pronës së Infrakosit, komuna nuk do ta pengojë projektin e rehabilitimit të linjave dhe objekteve të tjera hekurudhore dhe se do ta ndihmojë në çdo aspekt Infrakosin si dhe koordinimin e të gjitha çështjeve lidhur me infrastrukturën hekurudhore, infrastrukturën e komunës që ndërlidhet me pronën apo infrastrukturën hekurudhore me qëllim të ofrimit të zgjidhjeve në interes publik, në interes të dy entiteteve dhe aspekteve të tjera të bashkëpunimit në funksion të interesit publik. Në fund të takimit, Bahtiri dhe Ramosaj janë pajtuar se, përveç marrëveshjes së nënshkruar, të kenë komunikime më të shpeshta për çështje që kanë të bëjnë mes Komunës dhe Infrakosit, në mënyrë që bashkëpunimi të jetë më efikas.



## Komuna e Rahovecit pranon një udhëzues për kultivuesit e serrave



RAHOVEC, 3 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka pritur në takim Bernandina Krasniqi, koordinatore e projektit "Crimson Capital", implementimi i teknologjive të reja në serra, projekt ky i cili mbështetet nga USAID-i. Latifi ka bërë me dije se Krasniqi ka sjellë në Rahovec një udhëzues për kultivuesit e serrave në Kosovë, ku kjo komunë së shpejti do të organizojë një punëtori për t'i infor-

muar fermerët për përdorimin e këtij udhëzuesi. "Krasniqi ka sjellë sot në Komunën e Rahovecit një udhëzues për kultivuesit e serrave në Kosovë, e që së shpejti Komuna e Rahovecit do të organizojë një punëtori në bashkëpunim me USAID-in, punëtori kjo e cila do të mbahet me fermerët e komunës sonë për informim më të hollësishëm lidhur me përdorimin e këtij udhëzuesi nga fermerët tanë. E informova znj. Krasniqi për

implementimin e projektit të serrave në komunën tonë dhe interesimin e Komunës së Rahovecit për përkrahjen e mëtutjeshme të fermerëve me serra, e sidomos me implementimin e teknologjive të reja në serra. Fermerë të nderuar, në ditët në vijim do t'ju mbajmë të informuar lidhur me kohën e mbajtjes së punëtorisë dhe procedurat se si mund të përfitonin nga ky udhëzues", ka thënë Latifi.

## Malishevë, asnjë i infektuar nga rriqrat

MALISHEVË, 3 KORRIK (ER) - Shtabi Komunal për Menaxhimin e Situatës Endemike me Ethe Hemorragjike Krime Kongo (EHKK) në Komunën e Malishevës, në mbledhjen e mbajtur të premten, e ka vlerësuar të qetë situatën me EHKK dhe nën kontroll. Në këtë mbledhje është bërë me dije se nuk ka asnjë rast të infektuar me EHKK.

Kryetari i këtij shtabi, Liridon Hoti, ka thënë se shqetësimi për mosrealizimin e repelimit të kafshëve, proces i cili në vitet e kaluara ka luajtur rol të madh, pasi repelimi konsiderohet si një proces i cili ndërpret ciklin e rriqrave dhe bartjen e tyre nga fusha. "Prandaj edhe një herë kërkohet nga qeveria qendrore, që ta vazhdojë projektin për repelimi të kafshëve. Kur kraha-

sohen shifrat e të pickuarve nga rriqrat, në vitin paraprak, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2019 kemi pasur 942 të pickuar nga rriqrat, kurse këtë vit në gjashtëmujorin e parë kemi të pickuar 837 qytetarë", ka thënë Hoti.

Po sipas këtij shtabi, deri më tani procesi i dezinfektimit të zonave endemike është duke shkuar mirë.



## Vazhdon mirëmbajtja e parkut rekreativ "Te Pishat" në Sllatinë



FUSHË KOSOVË, 3 KORRIK (ER) - Komuna e Fushë-Kosovës ka njoftuar se ekipet mobile të kësaj komune dhe kompania "Pastrimi" janë duke u marrë me pastrimin e hapësirave të parkut rekreativ "Te Pishat" në Sllatinë. "Mbeturinat e shumta, të hedhura vend e pavend

nga qytetarët, po ndikojnë në një pamje jo të mirë të këtij kompleksi shumë atraktiv dhe ndër të paktët në këtë regjion, andaj edhe kërkesa e shërbimeve përkatëse komunale është që qytetarët t'i mirëmbajnë këto hapësira dhe mbeturinat t'i hedhin në vendet e

caktuara dhe jo në sipërfaqet e gjelbra. Gjithashtu, luten qytetarët që të mos i dëmtojnë ulëset, rekuizitat e ndryshme sportive si dhe pajisjet e lojërave për fëmijë. Bashkë ta ruajmë dhe ta mirëmbajmë ambientin", ka njoftuar Komuna e Fushë Kosovës.

# MBYLLENI GJYKATËN SPECIALE!



Nga Harry BAJRAKTARI

Dhoma Speciale e Kosovës (e njohur si Gjykata Speciale) ka njohtuar figurën e saj duke ndërhyrë me një proces politik: Nismën e ShBA-së për të ndërmjetësuar mes Kosovës dhe Serbisë.

Zyra e Prokurorit të saj bëri publike një padi të mundshme kundër presidentit Hashim Thaçi derisa ky ishte duke fluturuar drejt Uashingtonit për një takim me homologun e vet serb Aleksander Vuçiq. Thaçi e ndërpreu menjëherë udhëtimin dhe me anë të një deklaratë publike premtoi të japë dorëheqje nëse paditet. Ai përsëriti besimin se do të dalë i pafajshëm.

E kam kritikuar Thaçin në të kaluarën dhe kam shprehur dyshimet e mia për çfarëdo bisedimesh me Serbinë që përfshijnë ndryshime të kufirit. Mirëpo, e mbështes deklaratën e tij dhe ndaj të njëjtin dyshim me të për këtë abuzim flagrant nga ana e Gjykatës Speciale.

Kjo gjykatë e pazakontë i është imponuar padrejtësisht Kosovës. Themelimi i saj më 2015 u bë me një vendim të Kuvendit të Kosovës përmes një presioni të paparë nga

komuniteti ndërkombëtar. Shumë deputetë votuan në bazë të informacionit se ekzistonin prova të qarta për krime lufte. Gjykata Speciale filloi punën shpejt pastaj në 2016-n. Nuk ka asnjë logjikë që asgjë nuk ndodhi në gjithë këto vjet e që, më në fund, një padi e mundshme u bë publike vetëm kur Thaçi u nis drejt Uashingtonit për t'i nisur bisedimet. Kjo padi mund të ishte ngritur tre muaj më parë. Ose gjashtë muaj më parë. Ose një vit më parë. Ose ditë pas bisedimeve në Uashington. Sidomos nga që nuk ishte vërtet një padi zyrtare, po një kërkesë për padi. Çfarë është bërja e saj publike në këtë kohë përveçse një lëvizje me synime politike? Një veprim i nxituar, pas vitesh përgjumjeje.

Unë po ua lë analistëve dhe opinionistëve politikë ta gjejnë se pse e nga kush u sabotuan bisedimet e ndërmjetësuar nga ShBA-ja. Mirëpo, është me rëndësi ta shqyrtojmë këtu rolin e Gjykatës Speciale.

Vitin e kaluar në mënyrë të ngjashme kryeministri Ramush Haradinaj u urdhërua që të paraqitej në Hagë. Ai u bind dhe menjëherë dha dorëheqje nga posti i kryeministrit. Momenti ishte përsëri i dyshimtë. Haradinaj ishte duke i rezistuar presionit të madh ndërkombëtar për ta anuluar tarifën ndaj mallrave serbe. Mbase këto janë thjesht rastësi, mirëpo edhe një herë tjetër

Gjykata Speciale u kap duke kryer veprime që më shumë kanë efekt politik sesa vlerë për drejtësinë. Nuk duhet harruar se Haradinaj ishte gjykuar tashmë dy herë në Tribunalin e famshëm të Hagës për ish-Jugosllavinë. Si askush tjetër në histori. Dhe që të dy herët ishte shpallur i pafajshëm.

Por, edhe pa këto veprime të njohtuara nga politika, Gjykata Speciale mbetet thellësisht problematike dhe diskriminuese që në thelb. Ajo është hartuar që t'i përndjekë vetëm shqiptarët në një shtet shumetnik. Kjo është një fyerje për çdo parim që komuniteti ndërkombëtar ka predikuar në rajonin tonë. Nga njëra anë drejtësia ka dështuar në përndjekjen e kriminelëve të luftës që vranë mijëra civilë, përdhunuan mbi njëzet mijë vajza dhe gra shqiptare, dëbuan me dhunë mbi një milion shqiptarë nga trojet e tyre, shkatërruan qindra objekte të kultit, e dogjën dhe e vodhën mbarë vendin. Nga ana tjetër, i vetmi grup për të cilin ekziston një gjykatë tani është një grup të rinjsh që u ngritën për t'i mbrojtur me armë shtëpitë, familjen dhe lirinë e tyre.

Edhe vetë themelimi i Gjykatës Speciale tani përngjan jo si një përpjekje për të sjellë drejtësi, por si një akrobaci politike për të krijuar barazim mes palëve, një lloj shprehje e shëmtuar e dyanshmërisë, që krahason agresorin me viktimën. Ne i jemi përjetë mirënjohës

Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për luftën e saj për liri dhe demokraci.

Anëtarët e UÇK-së, udhëheqësit e të cilëve kërcënohen nga Gjykata Speciale sot, nuk shkuan në Beograd apo në qytetet serbe për të luftuar e vrarë. Përkundrazi, makina ushtarake serbe dhe gangsterët paraushtarakë erdhën tek ata. Te shtëpitë e tyre, te familjet e tyre, te jetët e tyre për të kryer gjenocid. Regjimi i Millosheviqit kishte nevojë për një luftë të re që të mbijetonte dhe ua imponoi një luftë të re. Mirëpo, si e gjithë bota, edhe të rinjtë që u bashkuan me UÇK-në e kishin parë se çfarë kishte ndodhur në Bosnjë dhe vendosën t'i mbrojnë me çdo kusht familjet, shtëpitë dhe lirinë e tyre.

Ndërkohë që agresorja, Serbia, nuk i ka dënuar kriminelët e saj të luftës, nuk ka kërkuar falje për krimet e tyre dhe nuk ka ofruar asnjë dëmshpërblim për dëmet e rënda të luftës në Kosovë, ajo ka ecur lehtësisht në integrimin evropian.

Ministri i saj i Jashtëm, Ivica Daçiq, ka qenë ministër i Informacionit në regjimin e Millosheviqit. Presidenti Vuçiq ka qenë zëvendësi i udhëheqësit me fashist të Serbisë, Vojslav Sheshelj dhe nxitës i krimeve të luftës në Bosnje. Komuniteti ndërkombëtar duhet të turpërohet që i trajton këta apologjistë të krimeve të luftës si partnerë të respektuar. Dhe sigurisht nuk është

presidenti i Serbisë, por ai i Kosovës që kërcënohet me gjykatë sot. Jo njerëzit që u përpoqën të kryejnë gjenocid, por ata që i rezistuan janë nën hetim.

Çfarë ironie themelimi i kësaj Gjykate anti-shqiptare Speciale në një kohë kur Serbisë nuk po i kërkohet llogari për terrorizmin e saj shtetëror në vitet 1990. Kur udhëheqësit e saj as që po tregojnë keqardhje për çfarë ndodhi. Kur, përkundrazi, po tallen me viktimat dhe thirrjet e tyre për drejtësi dhe po i trajtojnë sikur këta të ishin kriminelët.

Nëse Gjykata Speciale nuk zgjeron punën e saj për t'i përfshirë krimet e të gjitha etnive në Kosovë dhe premtom të mos përzihet në çështje politike, atëherë Kuvendi i Kosovës duhet ta rishikojë vendimin e vet si dhe statusin e kësaj gjykate. Standardet e dyfishta e të zbatuara haptazi janë një ofendim për viktimat e luftës. Nëse nuk vini dot në vend drejtësinë, të paktën mos u tallni me ta.

*(Harry Bajraktari është themelues dhe botues i gazetës Illyria (1991-1998), një drejtues i komunitetit shqiptaro-amerikan, filantrop dhe përfitues i shumë çmimeve, duke përfshirë Nderin e Urdhrit të Kombit nga Presidenti i Shqipërisë, Medaljen Presidenciale të Kosovës për Meritat & Bardhë Thirrja Presidenciale e Shtëpisë për Çmimin e Shërbimit).*

## GJYKATA THEMELORE NË PEJË DHE AJO GJAKOVË BËHEN ME KRYETARË TË RINJ

PEJË, 3 KORRIK (ER) - Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK) përmes aplikacionit "Zoom" ka mbajtur takimin e 235-të me radhë nën udhëheqjen e kryesuesit Skender Çoçaj, me ç'rast janë diskutuar dhe miratuar pikat sipas rendit të ditës.

Takimi ka filluar me aprovimin e plotësim/ndryshimit të vendimit të KGjK-së, të 23 qershorit 2020, për miratimin e listës së gjyqtarëve për të qenë pjesë e listës së paneleve hetimore, me mandat trevjeçar.

Gjatë këtij takimi anëtarët e KGjK-së kanë zgjedhur anëtarin e Komisionit për Rishqyrtim të Ankesave, gjyqtarin Diellza Hoxha. Po ashtu, pas zhvillimit të procesit të votimit, me shumicë votash kanë përzgjedhur dhe emëruar kryetarin e Gjykatës Themelore në Pejë, gjyqtarin Armend Berisha, si dhe kryetarin e Gjykatës



Themelore në Gjakovë, gjyqtarin Nikollë Komoni.

Anëtarët e KGjK-së kanë aprovuar kërkesën e kryetarit të Gjykatës Themelore në

Mitrovicë, Nikolla Kabashiq, lidhur me transferimin e një gjyqtari në Gjykatën e Apelit, të cilit paraprkasht i lejohet përfundimi i një lënde

penale. "Mes të tjerash, është diskutuar edhe situata e gjyqësorit dhe përshtatja e punës së gjykatave në gjendje të pandemisë, me ç'rast krye-

suesi Çoçaj u ka bërë thirrje të gjitha gjykatave, që organizimin e punës ta bëjnë në përputhje me rekomandimet e IKShPK-së.

## Trumpi: ShBA-ja do ta ketë shpejt vaksinën kundër koronavirusit

WASHINGTON, 3 KORRIK - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ka shprehur optimizmin se ShBA-ja do të dalë së shpejti me një vaksinë kundër koronavirusit, duke thënë se tre kërkues të tyre "duken vërtet, vërtet mirë". "Mendojmë se do ta kemi shpejt", tha Trumpi në një ngjarje në Shtëpinë e Bardhë, por pa dhënë hollësi të tjera. Komentet vijnë kur numri i të infektuarve me koronavirus brenda një dite në ShBA ka kaluar 50 000 për herë të parë. Kjo duket se ka ndryshuar edhe

qëndrimin e presidentit Trump në lidhje me maskat mbrojtëse. "Mendoj se maskat janë të mira", tha Trump për "Fox Business". "Njerëzit më kanë parë me maskë", shtoi ai. Trumpi është kritikuar për rezistimin e tij ndaj veshjes së maskës. Por, me rritjen e numrit të rasteve në ditët e fundit, ai tha: "Nëse do të isha në një situatë të ngushtë me njerëz, unë do të vishja absolutisht". Shtetet e Bashkuara kanë numrin më të madh të të



infektuarve dhe viktimave me koronavirus: mbi 2.7 milionë, përkatesisht mbi 128 000. Sipas të dhënave të Universitetit "Johns Hopkins", në gjithë botën janë infektuar mbi 10.7 milionë njerëz. Prej tyre, mbi 517 000 kanë vdekur dhe mbi 5.5 milionë janë shëruar. Javën e kaluar, kreu i Organizatës Botërore të Shëndetësisë, Tedros Adhanom Ghebreyesus, ka thënë se nuk ka garanci se shkencëtarët do të mund të zbulojnë një vaksinë efektive kundër Covid-19, sëmundjes që e shkakton koronavirusi.

## Macron emëron Jean Castex kryeministër të Francës



PARIS, 3 KORRIK - Presidenti francez Emmanuel Macron ka emëruar nëpunësin e lartë civil, Jean Castex, i cili hartoi politikën për lehtësimin e masave të izolimit gjatë pandemisë, si kryeministër të ri të vendit. Vendimi është pjesë e një riorganizimi qeveritar. Castex, 55-vjeçar, ka shërbyer

gjithashtu si president i Agjencisë Kombëtare të Sporteve në Francë dhe ka mbikëqyrur përgatitjet për Lojërat Olimpikë të "Paris 2024". Pallati Elysee njoftoi emërimin më 3 korrik, vetëm disa orë pasi Edouard Philippe dha dorëheqje si kryeministër. Masa e Macronit për ta

rifreskuar qeverinë e tij vjen pasi partia e tij shënoi humbje në zgjedhjet lokale. Vëzhguesit thonë se zëvendësimi i Philippes, i cili është më i popullarizuar në publik sesa presidenti, mund të provokojë një bixhoz të rrezikshëm politik për Macronin, pasi ish-kryeministri mund të dalë si një rival presidencial më 2022.

## Teksasi e bën të detyrueshme mbajtjen e maskës


KALIFORNI, 3 KORRIK - Guvernatori i Teksasit në ShBA, Greg Abbott, ka urdhëruar qytetarët t'i mbajnë maskat mbrojtëse në publik pasi rritjes së numrit të rasteve me koronavirus në këtë shtet amerikan. Teksasi arriti një rekord të rasteve me Covid-19, pasi vetëm të mërkurën u konfirmuan më shumë se 8 000 të infektuar me koronavirus. "Mbajtja e maskës në fytyrë do të na ndihmojë ta mbajmë

Teksasin të hapur për biznes", ka thënë Abbott, pasi njoftoi për vendimin. Banorët që refuzojnë ta vendosin maskën do të përballen me gjobë deri në 250 dollarë. "Më lejoni të jem i qartë: askush nuk mund të burgoset për shkeljen e kësaj praktike", ka thënë guvernatori. Ai paralajmëroi se disa njësi të kujdesit intensiv ishin pothuajse të mbushura me pacientë. Në vendimin për mbajtjen e maskës nuk janë të

përfshirë fëmijët që janë 10 vjeç ose më të rinj, ata që kanë një gjendje mjekësore e cila i pengon ta veshin maskën, personat që janë duke ngrënë ose pirë dhe ata që bëjnë aktivitete fizike në ambient të hapur. Shtetet e Bashkuara janë goditur më së keqi nga pandemia e koronavirusit. Deri më tani ka pasur 2.7 milionë raste të të infektuarve në shkallë vendi dhe më shumë se 128 000 vdekje.



## Gjendje e jashtëzakonshme në Beograd për shkak të koronavirusit



BEOGRAD, 3 KORRIK - Serbia shpalli gjendje të jashtëzakonshme në Beograd dhe rivendosi një sërë kufizimesh për ta ngadalësuar përhapjen e koronavirusit. Qeveria njoftoi të premten se veshjen e maskave e ka bërë të detyrueshme në hapësirat e mbyllura publike dhe në transportin publik. Po ashtu, u bë e ditur se klubet e natës dhe kafenetë do të qëndrojnë të

mbyllura nga ora 23:00 deri në 06:00, ndërsa tubimet do të kufizohen në 100 persona brenda dhe në 500 jashtë. Ata që nuk mbajnë maska në hapësira të mbyllura përballen me gjoba. Bashkia e Qytetit të Beogradit tha të premten se gjendja e jashtëzakonshme hyn në fuqi menjëherë. Një ditë më parë Serbia ka raportuar 359 raste të reja me

koronavirus - 80 për qind e të cilave kanë qenë në Beograd dhe në rrethinat e tij. Në total, Serbia ka konfirmuar mbi 15 000 raste me koronavirus dhe 287 viktima. Për shkak të rritjes së numrit të rasteve të reja në ditët e fundit, edhe disa qytete të Serbisë, përfshirë: Novi Pazarin, Tutinin, Kragujevcin dhe Vranjen, kanë shpallur gjendje të jashtëzakonshme.

## Në Turqi nis procesi gjyqësor për rastin Khashoggi

ANKARA, 3 KORRIK - Të premten një gjykatë turke hapi gjyqin ndaj 20 zyrtarëve sauditë, të akuzuar për vrasjen e gazetarit Jamal Khashoggi, një kritik i

shquar i udhëheqjes saudite. Ai shkruante për gazetën amerikane "Washington Post". Në shkrimet e tij Khashoggi ishte shumë kritik ndaj

sundimtarit de fakto të Arabisë Saudite, Princit të Kurorës, Mohamed bin Salman. Khashoggi u vra në Konsullatën Saudite në Stamboll në muajin

tetor të vitit 2018. Zyrtarët sauditë kishin thënë se vdekja e tij ishte rezultat i një "operacioni mashtrues" dhe nuk ishte urdhëruar nga shteti.



# OSMAN ZHITIA DJALË DHE BABA I MADH E BESNIK I IDEALEVE KOMBËTARE TË BABAIT SYLËS DHE TË BIRIT TË TIJ AFRIM ZHITISEA



## Ismet SYLEJMANI

*Shumë e dashur dhe e nderuar Nana Qamë, i dashur dhe shumë i nderuar Naim, Dritero, Flamur dhe pjestarë të familjes së ngushtë e të gjerë Zhitia! Të nderuar të pranishëm!*

Sot u ndal zemra e madhe e Axsës Osman Zhitia!

Sot pushoi së rrahuri zemra e djalit të Heroit të Popullit Sylë Durmishi!

Sot mbylli sytë përgjithmonë Babai i Heroit të Kombit Afrim Zhitia!

Sot u nda nga jeta njeri prej baballarëve më të mëdhenj të Heronjëve dhe Deshmorëve të Kombit!

Axha Osman Zhitia, ishte dhe mbetet babai simbol i të rënëve për liri dhe pavarësi të Atdheut! Të nderuar pjesmarrës në varrimin e Axsës Osman Zhitia, Axha Osman jetoi një jetë me dinjitet të plotë, por edhe kishte tronditje e kishte dhembje në jetën e tij!

Kishte krenari të madhe dhe e jetoi jetën me nderë dhe nderime nga të gjithë dhe kishte shumë që e donin dhe e nderonin, jetë të cilën jo çdo kush e ka pasur!

Osman Zhitia në jetën e tij kishte furtuna të mëdha!

Llapjani luan i Llugës së pamposhtur e heroike, ishte i destinuar të ishte i madh e i papërkulur, sepse të tillë e bënë Babai i Tij dhe Djali i Tij!

Partizani antifashist, luftëtari me armë në duar Sylë Durmishi, babai i Axsës Osman Zhitia nga i cili po ndahemi sot, frontin e luftës çlirimtare antifashiste e kishte filluar në truallin e Shqipërisë Nanë, në atë truall e aty ku lufta antifashiste kundër pushtuesve dhe tradhtarëve bëhej dhëmb për dhëmb!

Me ato ideale e dëshira për liri e çlirim, vritet në Mushnikovë nga forcat çetnike serbe dhe kolaboracioniste!

Përfundimi i Luftës së Dytë Botërore dhe fillimi i natës së errët të Jugosllavisë titiste dhe Serbisë së krajleve mbi Kosovën dhe popullin shqiptar, e gjenë Axsën Osman Zhitia, jetim e në udhët e mëdha të jetës!

Osman Zhitia, zbaton një beslidhje burrash e heronjësh, që kishin lidhur mesveti dy fatosat e maleve, lirishtetësit Heronj Sylë Durmishi dhe Hakif Rimanishita.

Osman Zhitia nisë jetën e përbashkët me Qamile Rexhen, Nënë heroinë që 6popullit dhe Atdheut do ti kryente lindjen më të madhe, sepse do te ia sillte në jetë Udhëheqesin e madh e të lavdishëm, te papërsëritshmin Heroin e Kombit Afrim Zhitia.

Axsës Osman Zhitia, nuk mundën të ia thenin mendjen pushtuesit sebo-jugosllav!

Ky vigan popullor, jo vetëm nuk u thy e nuk u dorëzua, por fëmijeve te Tij, ua ofroi me knaqësi e bindje të madhe

rrugën dhe jetën në të cilën lufta për Komb, popull e Atdhe, ishte me prioritet absolut, ashtu sikur buka e kripa, sikur nata e dita, sikur uji e toka! Heroi i Kombit Afrim Zhitia ishte më i madhi i të mdhenjëve, por të tillë e mbajti edhe Babushi i Tij i madh, simboli i baballarëve të burgosurve politik dhe më vonë edhe i Heronjeve dhe Deshmorëve të kombit.

Kudo që ka marrë pjesë e kudo që ka qëndruar Osman Zhitia, aty ai vend, ajo odë e ajo sallë tubimesh të mëdha e koncertesh, ka shkelqyer nga buzqeshja e Tij e madhe dhe karakteristike, si vete Ai që e kishte zemrën të bardhë por që kurr nuk arritën të ia nxinin pushtuesit e tradhtarët, ndonëse jetën u munduan të ia nxinin dhe në masë të madhe edhe ia arritën.

Misionin e madh e te çeliktë të djalit të Tij Lavdimadh Afrim Zhitia, Axha Osman e vazhdoi në formën e tij të madhe dhe krejt origjinale, në shërbim të Atdheut dhe aspiratës shekullore të popullit shqiptar!

Udhëheqja e Lëvizjes Popullore të Kosovës, në vitet 1991/1992 mbajti njerën nga mbledhjet e sajë ne shtëpinë e Osman Zhitisë këtu në Llugën heroike, dhe Axha Osman ishte mikëpritësi i madh!

Lufta çlirimtare heroike dhe titanike e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kishte bindur përfundimisht plakun e palëkunj

dur, se pavarësia e Kosovës nga Serbia pushtuese ishte çështje që ishte nisur për të përfunduar përgjithmonë!

Vdekja e hershme e djalit të tij, shokut e mikut tonë Sylë Zhitia, i cili para disa ditësh u nda nga jeta, i kishte dhënë një goditje të madhe Axsës Osman, i cili sikur edhe Nana Qamë dhe e gjithë familja nuk e merituan këtë merzi të madhe!

*Të nderuar të pranishëm,*

Ky varrim nuk është e nuk do të jetë i rendomtë, sepse do të mbahet në mend gjatë, ngase po ndodhë një histori që brezat do të shkruajnë, historia do të mbajë orën e saj, poetët e shkrimtarët, historianët e aktorët do të krijojnë krijimet e tyre të mëdha, kurse politikanet patriot e atdhetare do ta perdorin si fakt e argument të madh se si edhe me varre i sherbehet unitetit popullor e nderimit të së kaluarës politike atdhetare!

Axha Osman sot do të varroset në varrin e djalit te tij, ne varrin e Heroit te Kombit Afrim Zhitia, i cili për dy dekada qëndroi aty dhe u nderua e u vizitua nga qindra e mijera shqiptarë! Pra sot Babi varroset në varrin e të birit të tij!

Jo vetëm me jetën e tij të

bujshme, por edhe me vdekjen dhe me varrimin dhe varrin e tij, Osman Zhitia, do të mbetet në historinë e popullit shqiptar, si njëri nga figurat dhe personalitetet e mëdha e me ndikim pozitiv politik popullor e adhetar për çlirimin e Kosovës dhe pavarësinë e sajë!

Lamtumirë Axha Osman, fale-minderit shumë që bashkë me Nënë Qamë, Sylën, Naimin e Sadeten, ma keni bërë respektin dhe dhënë nderimin e madh që të isha ideatori dhe ndertuesi i këtij monumenti gjigant Obelisku i Heroit të Kombit Afrim Zhitia.

Bani të fala Afrim Zhitisë e Sylës, Fadilit e Fahriut, bani të fala Gjeneral Fehmiut, se shumë e ke dashur dhe shumë na ke folur për Të.

Lamtumirë Babushi i Afrim Zhitisë!

Përgjithmonë burrit të madh te Kosoves, te pavdekshmit Osman Zhitia i qofte lavdi!

Lavdi djalit të Tij Heroit të Kombit Afrim Zhitia! Nderim për Sylë Zhitinë!

*Prishtinë, 2 korrik 2020!*

*Fjalim pranë Obeliskut te Heroit të Kombit Afrim Zhitia, në ceremoninë lamtumirëse në varrimin e Axsës Osman Zhitia!*



E rrallë

# Hotel prej ari në Vietnam, gjithçka e larë në flori

Një hotel, i cili është i pari në botë i larë me flori, është hapur në kryeqytetin vietnamez Hanoi. Gjithçka, që nga tualetet e deri te vaskat, nga lugët e pirunët e deri te dushet, në hotelin "Dolce Hanoi Golden Lake" është e larë me flori 24 karatësh. Ka madje edhe një pishinë të larë në flori që ofron një fushëpamje nga qyteti. Por, mysafirët duhet të nxjerrin nga xhepat 250 ose më shumë dollarë për një nga 260 dhomat në hotelin me 25 kate në Hanoi, ku edhe vaktet mund të jenë të përziera me pluhur ari. "Hoteli ka në shënjestër këdo, që nga njerëzit e thjeshtë e deri te



super të pasurit, që mund ta vizitojnë atë dhe ta reklamojnë pushimin e tyre atje në të gjithë botën", kanë thënë drejtuesit e tij. Për ndërtimin e hotelit janë dashur afërsisht 200 milionë dollarë, kanë thënë pronarët e këtij hoteli.

## BARSOLETA E DITËS



Polici para çerdhes së fëmijëve

Eduktorja: Mirëdita zotëri polic!

Polici: Mirëdita!

Eduktorja: Po prisni ndonjë fëmijë?


Polici: Jo more. Këtë bark e kam që sa vite kështu!



Në Kino ABC nuk ka shfaqje

E jashtëzakonshme

## Zbulohen insektet 99 milionë vjeçare të ruajtura në qelibar



Insekte prehistorike të bllokua në qelibar për 99 milionë vjet kanë nxjerrë në dritë detaje mahnitëse rreth krijesave të asaj periudhe. Një studim i bërë kohën e fundit i ka përdorur kandrrat e ngecura në qelibar për të hedhur një vështrim më të qartë mbi botën e ngjyrave antike. "Shkencëtarët do ta kishin të vështirë të përpiqeshin të imagjnonin vetë në hollësi se si dukeshin krijesat prehistorike

sepse shumica e fosileve dhe eshtrave nuk na japin shumë të dhëna", ka thënë Pan Yanhong nga Akademia Kineze e Shkencave. Sipas tij, ngjyrat e mrekullueshme që kanë këto insekte të ruajtura në mënyrë të përkryer shkaktohen nga struktura mikroskopike në sipërfaqen e insektit. Nanostruktura e kësaj sipërfaqeje e shpërndan dritën e gjatësive valore specifike dhe prodhon ngjyra shumë intensive.

### FOTO E DITES



Vizita e parë zyrtare e kryeministrit Avdullah Hoti në Shqipëri pritet me ceremoni shtetërore nga homologu shqiptar Edi Rama.



#### DASHI

Do të ndiheni për mrekulli në krahët e atij që dashuron dhe do të doni të mos shkëputeni për asnjë çast. Beqarët do jenë gati të bëjnë çdo lloj çmendurie.



#### DEMI

Projektet e përbashkëta që keni nisur do t'ju afrojnë edhe më tepër me partnerin tuaj gjatë kësaj dite.



#### BINJAKËT

Më në fund do ta kaloni situatën delikate që ka mbizotëruar në jetën tuaj në çift dhe do të ndiheni mjaft mirë në krahët e partnerit.



#### GAFORRJA

Do të vuani mjaft vetminë sot ju beqarët dhe do të bini shpesh në melankoli. Fatkeqësisht, mundësitë për takime do të mungojnë tërësisht.



#### LUANI

Merrni kohën e duhur për t'i njohur sa më mirë ata. Në planin financiar do t'ju dalin para probleme serioze të cilat vetëm me ndihmën e të tjerëve do të mund t'i kaloni.



#### VIRGJËRESHA

Do ta ruani bashkëpunimin në çift gjatë gjithë kësaj dite dhe do të ndiheni mjaft mirë në krahët e partnerit tuaj.



#### PESHORJA

Ditë mjaft premtuese kjo e sotmja për të dashuruarit. Do t'i kuptoni gabimet e bëra dhe gjeni mënyrën e duhur për të kërkuar falje.



#### AKREPI

Nëse jeni në një lidhje do të kaloni një ditë shumë të bukur dhe të mbushur plot emocione sot. Do të ndiheni më të bekuar se kushdo tjetër nga yjet.



#### SHIGJETARI

Do të jeni i vetëdijshëm për hapat që do të hidhni dhe nuk do të nxitoheni për asgjë. Beqarët nuk do të ndihen ende gati të bëjnë ndryshime të rëndësishme në jetën sentimentale.



#### BRICJAPI

Mos hezitoni t'i shprehni sa të mundni ndjenjat gjatë kësaj dite sepse vetëm në këtë mënyrë do ta mbani zgjuar dashurinë dhe ngrohtësinë në çift.



#### UJORI

Ditë e mrekullueshme kjo e sotmja për të gjithë ata që janë në një lidhje. Të ardhurat do të fillojnë të stabilizohen dalëngadalë.



#### PESHQIT

Venusi do të jetë i pozicionuar më së miri sot në jetën tuaj sentimentale dhe do t'ju bëjë të përjetoni kënaqësi pa fund.

## Partnerja e Icardit nuk përmbahet, pozon me rroba banje

Wanda Nara di si ta kthejë vëmendjen nga ajo. Partnerja e Mauro Icardit, Wanda Nara, vazhdon të jetë emër shumë i komentuar. Ajo njihet për paraqitjet provokuese në rrjetet sociale, në të cilat ndiqet nga një numër i madh personash. Wanda kujdeset shumë edhe për linjat trupore, rezultatet e të cilave po i tregon vazhdimisht me pozat gjysmë e zhveshur. Së fundi ajo publikoi një foto atraktive, ku shihet e veshur me një palë bikini, ndërsa ishte lagur pranë ujit. Wanda Nara nuk i kursen as setet fotografike pranë futbollistit, ku komentohej shumë për paraqitjet joshëse.



### Arta paraqitet seksi në jaht

Arta Nitaj me në fund është "arratisur" nga Kosova. Pandemia e Covid-19 kishte bërë që shumë modeluese e bukuroshe kosovare të vetizolohen. Disa prej tyre edhe kishin vuajtur derisa disa kishin mbetur edhe jashtë kufijve të shtetit për shkak se masat kundër kësaj sëmundje

kishin pezulluar edhe shumicën e fluturimeve. Por, tani, bukuroshja pejane ka shfrytëzuar masat e lehtësimit kundër pandemisë për të bërë një foto seksi në një jaht. Arta ishte aktive edhe para largimit ku vazhdimisht ka postuar fotografi, por edhe video seksi nga vetizolimi.

## Melania Trump mban çantën më të shtrenjtë në botë



Melania Trump është mjaft e njohur për shpenzimet në gardëroba të shtrenjta, por nuk janë vetëm rrobat e saj që janë të trendit më të fundit. Zonja e parë e Shtëpisë së Bardhë gjatë ditës së e martë është parë me një aksesor, çmimi i së cilës është mjaft i lartë, rreth 12 mijë dollarë. Gjatë një takimi zyrtar të saj, Melania është parë duke mbajtur


një çantë të markës 'Hermes Birkin', që cilësohet si më të shtrenjtat në botë. Çantat "Birkin" morën emrin prej aktore dhe këngëtares Jane Birkin, ndërsa tani po konsiderohen si më luksozet. 50-vjeçarja mund të jetë tani zonja e parë e Shteteve të Bashkuara, por para se të jetë pjesë e politikës, ajo ishte e njohur për një karrierë të suksesshme në modelim.

## Urimi i Marinës për ditëlindjen e Getit: Doja të të uroja më të mirën, por ti më ke mua



Marina ka zgjedhur fjalët më të mira për ditëlindjen e Getoarit. Reperi i njohur shqiptar, Getoar Selimi, ka festuar ditëlindjen, duke mbushur 38 vjet jetë. Urimet për reperin kanë nisur që në minutat e parë të kësaj dite, ku më special i ishte ai i bashkëshortes së tij, Marina Vjollca. Kjo e fundit ka postuar një

foto të Getit në llogarinë e vet në "Instagram", në të cilën ka zgjedhur fjalët më të ëmbla për të, duke ia përmendur edhe faktin se është me fat që e ka atë. "Gëzuar ditëlindjen për burrin tim të dashur, heroin tim, burrin tim të bukur (unë doja të të uroja më të mirën, por ti pothuajse më ke mua. Nuk ke nevojë", ka shkruar Marina.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Manaj: Misioni për mbijetesë nuk është i paarritshëm



Arb Manaj ka thënë të premten për "Epokën e re" se Trepça '89 e ka të vështirë misionin e sigurimit të mbijetesës, por jo të pamundur. "Jemi katër pikë larg pozitës që na siguron mbijetesën. Ne do të luftojmë deri në fund dhe shpresoj ta arrijmë objektivin tonë. Kjo garë nuk do të jetë aspak e lehtë, pasi dihet se rivalët kryesorë për mbijetesë i kemi Drenicën dhe Flamurtarin", ka thënë Manaj

**EPOKA E RE**

**Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 3 KORRIK** - Skuadra e Trepçës '89 arriti fitore në ndeshjen e fundit kundër Drenicës në Skenderaj dhe me tri pikët e fituara ka mbetur në garë për mbijetesë. Arb Manaj ka thënë të premten për "Epokën e re" se skuadra nga Mitrovica arriti ta kapë trenin e fundit në garën për mbetjen në IPKO Superligën e Kosovës. "Mund të them se ishte treni i fundit për skuadrën tonë, duke e marrë parasysh që kishim një rival për mbijetesë. Të gjithë futbollistët kanë dhënë maksimumin ndaj Drenicës dhe në fund arritëm të fitojmë me plot meritë. Kjo fitore na ndihmon

shumë psikikisht dhe moralisht", ka deklaruar Manaj.

Futbollisti i talentuar ka konfirmuar se Trepça '89, edhe përkundër pozitës së paralajmëruar në tabelën e klasifikimit, nuk do të dorëzohet, por do të luftojë deri në fund për mbijetesë. Ai parashikon se kjo garë do të jetë mjaft e vështirë, por beson se skuadra e tij do t'ia arrijë në fund qëllimit. "Jemi katër pikë larg pozitës që na siguron mbijetesën. Ne do të luftojmë deri në fund dhe shpresoj ta arrijmë objektivin tonë. Kjo garë nuk do të jetë aspak e lehtë, pasi dihet se rivalët kryesorë për mbijetesë i kemi Drenicën dhe Flamurtarin", ka thënë Manaj. Futbollisti Manaj ka shkëlqyer me

fanellën e Trepçës '89, ani pse kësaj skuadre i kanë munguar rezultatet pozitive. Manaj kishte arritur të merrte ftesë nga përzgjedhësi i Kosovës, Bernard Challandes, për ndeshjen miqësore me Suedinë. Ndërsa tash ofertat në drejtim të tij vetëm sa po shtohen. Lidhur me të ardhmen, Manaj ka bërë me dije se do të vendosë pas përfundimit të kampionatit. "Kam oferta nga shumë shtete, po ashtu edhe nga Turqia, por njëherë e kam mendjen te kampionati dhe pastaj do t'i shikoj ofertat dhe do të vendos për të ardhmen time", ka shtuar ai. Skuadra e Trepçës '89 ndeshjen e radhës e zhvillon nesër (e diel) ndaj skuadrës së Ferizajt.

## Gjilani emëron Mujën trajner të juniorëve

**GJILAN, 3 KORRIK** - Ish-futbollisti i njohur në Kosovë, Premton Muja, është emëruar trajner i juniorëve në skuadrën e Gjilanit. Muja këtë detyrë do ta marrë nga edicioni 2020/2021. Ai është zotuar se do të përpiqet të punojë në maksimum në mënyrë që rezultatet mos t'i mungojnë skuadrës së Gjilanit. "Nga sezoni i vitit 2020/2021 do të jem trajner i juniorëve të Sc Gjilanit të gjeneratës U-19. Besimin që ma ka dhënë klubi



do të përpiqem ta kryej si është më së miri, që përgjegjësia dhe detyrat të kryhen sipas objektivave të klubit.

Falënderoj të gjithë një nga një, që nga presidenti Florim Zuka, drejtorët e klubit Sevdail Robelli, Sallah Sherifi, Naser Ajeti dhe koordinatoren e shkollës, Sadullah Ajeti", ka thënë Muja. "Stërvitjet kanë filluar të premten. Në ditët në vijim kemi seleksionim të lojtarëve nga klubet e ndryshme. Përkishtë seleksionimi po kryhet nga pesë trajnerë të shkollës së futbollit me përpikëri të lartë", ka shtuar ish-futbollisti i famshëm, Premton Muja.

SHKURT

### Useini: Nëse gabojmë ndaj Feronikelit humbim shpresat për titull

Gjilani gaboi në ndeshjen ndaj Llapit në xhiron e kaluar, kurse sot përballet me Feronikelin. Ky takim shihet mjaft vendimtar për fatin e skuadrës së Gjilanit sipas mesfushorit të ekipit, Muhamed Useinit. Ky i fundit për "Olle" ka thënë se në rast dështimi edhe në këtë takim, atëherë Gjilani mund t'i shuhet shpresat për titull. "Ndaj Feronikelit do të jetë e vështirë sepse Feronikeli ka një skuadër mjaft cilësore dhe të mirë, mirëpo Gjilani gjithmonë futet në ndeshje për tri pikë, kështu që, duke pasur parasysh hapin fals në ndeshjet e fundit, s'kemi zgjidhje tjetër, por vetëm të kthehemi me fitore nga Drenasi", ka thënë Useini. "Në rast të dështimit eventual në këtë sfidë, atëherë do të shuhet pothuajse shpresat për titull, pasi ngelin shumë pak ndeshje deri në fund", ka shtuar Useini.

### Arteta: Xhaka lë edhe pikën e fundit të gjakut në fushë

Mesfushori me origjinë shqiptare i Arsenalit, Granit Xhaka, shënoi golin e dytë në fitoren 4-0 kundër Norwichit. 27-vjeçari është titullar i padiskutueshëm në formacionin e Mikel Artetës, madje ky i fundit i ka thurur elozhe mesfushorit. "Xhaka është një lojtar që ka një përkushtim të jashtëzakonshëm. Ai lë edhe pikën e fundit të gjakut në fushë dhe në stërvitje. Është një shembull fantastik për shokët e skuadrës. Mënyra si ai kujdeset për veten është për t'u admiruar. Xhaka jeton me futbollin", ka thënë Arteta.

### Suzana Ujkiç vazhdon kontratën me KHF Istogu

KHF Istogu ka njoftuar se hendbollistja Suzana Ujkiç ka vazhduar kontratën edhe për një vit. Skuadra e Istogut e vlerëson si lajm shumë të mirë rinovimin e kontratës me Ujkiçin, pasi ajo është ndër hendbollistet më të dalluara në tre vjetët e fundit. "Për mua, siç e kam cekur gjithmonë, edhe këtë herë do të jetë nder dhe kënaqësi që do të jem pjesë e KHF Istogu edhe për një vit tjetër. Klubi sigurisht se do të përforcohet me disa hendbolliste kualitative dhe pres që në sezonin e ardhshëm ta kthejmë titullin e kampionit dhe Kupën e Kosovës përsëri në Istog. Të angazhohemi siç jemi angazhuar deri më tani dhe mos t'i ndalemi punës, sepse me punë dhe përkushtim të madh së bashku mund t'i arrijmë të gjitha", ka deklaruar Suzana Ujkiç.



## Aliu: Kampionet e Ferizajt gjithmonë do ta kenë përkrahjen time

**FERIZAJ, 3 KORRIK** - Ferizaj është kampion i Kosovës në hendboll në konkurrencën e femrave. Në finalen e zhvilluar ditë më parë Ferizaj doli skuadër më e suksesshëm se Istogu. Ndeshja e parë në

Ferizaj u fitua nga skuadra vendëse me rezultat 34:29, ndërsa në ndeshjen e dytë Istogu fitoi me rezultat 27:26, por festa u takoi lojtareve të Ferizajt. Kampionet gjatë janë pritur në takim nga i

pari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu. "Sot prita vajzat sukseseplot, trajnerët e drejtuesit e Klubit të Hendbollit Femrat 'Ferizaj' të cilat javën që shkoi i sollën Ferizajt e sportit ferizajas tit-

ullin e kampionit. Mbresëlënëse vullneti dhe pasioni i vajzave e menaxhmetit të klubit për t'i dhënë këtij sporti e Ferizajt ngjyrat e kampionit, përkrahje që do ta kenë përherë nga qeveria



ime", ka shkruar Aliu në "Facebook".

## Azemi: Nga Liga Kosovë - Shqipëri përfitojnë dy shtetet

**PRISHTINË, 3 KORRIK** - Analistët, trajnerët dhe basketbollistët po e përkrahin themelimin e Ligës Kosovë - Shqipëri. Federata e Basketbollit e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë janë duke punuar intensivisht që ëndrra e shumë shqiptarëve të jetësohet me formimin e kësaj lige. Një nga basketbollistët më me përvojë në vendin tonë është Edmond Azemi. Edhe Azemi e përkrah themelimin e kësaj lige. "Ideja e Federatës së Basketbollit të Kosovës dhe asaj të Shqipërisë për formimin e kësaj lige është shumë e qëlluar. Të gjithë kemi pasur ëndërr për formimin e një Lige Mbarëkombëtare. Duke marrë parasysh që vështirë se edicionin e ardhshëm mund të luajmë në Evropë, kjo Ligë do të na shërbejë shumë. Gjithashtu është shumë pozitive që ka marrë lejen nga FIBA Evropa", ka thënë kapiteni i Sigal Prishtinës për faqen zyrtare të FBK-së.



dhe të fitojnë përvojë. Në këtë mënyrë mund të kemi një gjeneratë të suksesshme. Ndërkohë, Shqipëria do të përfitonte sa i përket tifozëve, duke marrë parasysh se sporti numër një në Shqipëri është futboll. Besoj se Liga do të ishte shumë interesante.

Klubet tona duhet t'u japin hapësirë lojtarëve të rinj, derisa do të rritej interesimi në të dy vendet. Kjo Ligë, gjithashtu, ka shpenzime. Shpresoj se do të ketë përkrahje financiare nga institucionet e Kosovës, por edhe sponsorët e ndryshëm", ka shtuar Azemi.

Basketbollisti i Kosovës tregon çka mund të përfitojnë dy vendet. "Ne mund të përfitojmë vetëm nëse u japim hapësirë lojtarëve të rinj. Basketbollistët e ri kanë nevojë për ndeshje ndërkombëtare

## Presidenti i UEFA-s: Ndeshjet e Ligës së Kampionëve mund të luhen me tifozë

**NYON, 3 KORRIK** - Presidenti i UEFA-s, Aleksandër Çeferin, ka thënë se një vendim për sa i përket tifozëve gjatë ndeshjeve të Ligës së Kampionëve dhe Ligës së Evropës duhet të merret deri më 10 korrik. Të dyja kompeticionet do ta vazhdojnë formatin njëra në Portugali e tjetra në Gjermani, me ndeshjet që do të luhen pa tifozë. "Ne jemi në kontakt të vazhdueshëm me autoritetet në Portugali dhe Gjermani. Të enjten unë kam folur personalisht edhe me kryeministrin e Portugalisë", ka thënë Çeferin. "Ne do t'i ndjekim rekomandimet e autoriteteve dhe do të marrim një vendim së shpejti, me shumë mundësi deri më 10 korrik. Ne duam që tifozët të jenë të pranishëm, por nuk dimë sesa mund t'ua sigurojmë sigurinë e shëndetit", ka deklaruar Çeferin.



### SHKURT

#### Sane: Dua të fitoj sa më shumë trofe me Bayernin

Transferimi i ri i Bayern Munchenit, Leroy Sane, ka thënë se me skuadrën e re synon të fitojë sa më shumë trofe, derisa kryesori është ai i Ligës së Kampionëve. "Bayerni është një klub shumë i madh me synime të mëdha, siç janë dhe të miat. Jam shumë i lumtur dhe mezi po pres të stërvitem me ekipin. Dua të fitoj sa më shumë trofe me Bayernin dhe në krye të listës është Liga e Kampionëve", ka thënë Sane.

#### Messi do të largohet nga Barcelona

Lionel Messi nuk do ta rinovojë kontratën me Barcelonën pasi në vitin 2021, kur t'i përfundojë marrëveshja, do të largohet me parametër zero. Është kjo dëshira e yllit argjentinas i cili, kur t'i ketë mbushur 34 vjeç, do të kërkojë të provojë një përvojë të re. Sipas programit "El Larguero" në "Cadena Ser", drejtuesit e Barcelonës i kanë ofruar një kontratë të re deri në vitin 2023, gjashtë herë fituesit të Topit të Artë, por Messi tashmë e ka ndarë mendjen dhe ka vendosur ta respektojë kontratën aktuale me Barçën për t'u larguar pas një viti me 0 euro. Për momentin Manchester City i Pep Guardiols është klubi që ka shfaqur më shumë interes për argjentinasin, por e ardhmja e tij nuk dihet ende se në cilën skuadër do të jetë. Edhe Interi me pronarët e rinj kinezë po shfaq interesim të vazhdueshëm dhe është i gatshëm ta bëjë një tentativë për të transferuar Messin në "San Siro" për t'iu kundërpërgjigjur Juves që dy vjet më parë transferoi në Torino Cristiano Ronaldon.

#### Ibra mund t'i bashkohet Hammarbyt

Zlatan Ibrahimoviçi do të largohet nga Milani dhe destinacioni më i mundshëm është Hammarby, raporton "Sky Sport Italia". Kontrata e sulmuesit skadon në fund të sezonit dhe deri tani nuk ka shenja të rinovimit me kuqezinjët. "Sky Sport Italia" raporton se suedezi do të largohet nga Milani më 31 gusht dhe po mendon kthimin tek ekipi nga kryeqyteti i Suedisë. Ibrahimoviç zotëron 25 për qind të aksioneve të klubit suedez, ku edhe u stërvit gjatë periudhës së izolimit.

#### Mourinho kundër VAR-it

Trajneri i Tottenham Hotspurtit, Jose Mourinho, ka thënë se VAR-i i bën dëm futbollit, pas disfatës që pësoi skuadra e tij kundër Sheffield Unitedit (3-1) të enjten. "Mendoj se nuk mund ta them atë që e ndiej. Nuk është gjyqtari kryesori më. Kryesori tani është gjyqtari ndihmës, burrat dhe gratë me flamuj tani janë ndihmësgjyqtarë të gjyqtarit ndihmës", ka thënë Mourinho. "Gjyqtari duhet të jetë kryesori në fushë. Ne po shkojmë drejt një gjëje që është shumë e dëmshme për një sport që ne e quajmë sporti i bukur", ka deklaruar Mourinho.

#### Mercedesi dominon në prova, Ferrari shumë larg rivalëve

Në pistën e Zeltwegut është zhvilluar të premten sesioni i parë i provave të lira të garës së Çmimit të Madh të Austrisë, aty ku ditën e diel do të zhvillohet gara e parë sezonale e botërorit 2020 të Formula 1. Ashtu sikurse edhe pritej, makina e Mercedesit ishte më e shpejta në pistë. Lewis Hamiltoni ishte më i shpejti në pistë. Në vendin e dytë u rendit shoku i tij i skuadrës, Valtteri Bottas. Në vendin e tretë u klasifikua piloti holandez Max Verstappen me Red Bull, fitues vjet në këtë pistë. Pas tij u rendit McLaren i Carlos Sainz dhe Racing Point e Sergio Perez. Vetëm i dhjeti Charles Leclerc me Ferrari, që ishte 1 sekondë më i avashtë se Hamiltoni. Ndërsa Sebastian Vettel u klasifikua në këtë sesion të parë në vendin e 12-të. Provat zyrtare do të zhvillohen të shtunën (ora 15:00) dhe gara të dielën, me fillim nga ora 15:10.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se “Auto Taxi”, Prebreza SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me NRB: 811341809, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Auto Taxi”, Prebreza” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa bisnisom: 811341809, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

All clients are to be informed that the “Auto Taxi”, Prebreza” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811341809 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “Homesmile Group” Sh.p.k Fushë Kosovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

**DEBAT PUBLIK**

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shfrytëzimin e gurit gëlqeror në Radishec komuna e Prishtinës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 28.07.2020 në ora 13:00 në hapësirat e restorant “Guesst” në rrugën “Rexhep Luci” p.n., në Prishtinë do të organizohet debat publik nga kompania “Homesmile Group” Sh.p.k Fushë Kosovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shfrytëzimin e gurit gëlqeror në Radishec komuna e Prishtinës.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

**RESTAURANT**

**SWISS TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

**Haqif Fanaj shpall të pavlefshme diplomën me NR.1820 në Fakultetin Filozofik, dega e Historisë në UP. Të lëshuar me 31.08.1999.**

► Armend Raka shpall të pavlefshme dokumentet e firmës “IT Center” SH.P.K. Prishtinë.

► Edip Saitovic shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " 25 Maji " Lubinje e Eperme

► Hadmir Kryeziu shpall të pavlefshme dëftesat e vitit I,II shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Binella Sagdati shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

► Lëshoj banes me qira në lagjen Dardani. Banesa është 50 m2, e mobiluar në tersi dhe është e gatshme për banim. Banesa preferohet për qift familjar. Tel: 044-171-328.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banes me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkudjesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banes me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

C.nr.1363/2019

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, departamenti i përgjithshëm, gjyqtari Naim Mehulli në çështjen juridike të paditësit: Bajram Bajrami nga fshati Pantinë, Komuna e Vushtrisë me vendbanim në Mitrovicë, rr. "Ahmet Selaci", të cilin sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson Av. Elvir Imeri nga Mitrovica kundër të paditurës: Lora Borisova Aleksandrova nga Republika e Bullgarisë tani me adresë të panjohur, gjykata me datën: 17.06.2020 konform nenit 79.3 të LPK-së mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. Caktohet Av. Musa Damati** nga Mitrovica si përfaqësues i përkohshëm i të paditurës: Lora Borisova Aleksandrova nga Republika e Bullgarisë tani me adresë të panjohur.

**II.** Përfaqësuesi i përkohshëm në kuptim të nenit 82 të LPK-se, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjorë, të cilat i ushtron deri sa të paraqiten në gjykatë të paditurit apo përfaqësuesi me prokurë, respektivisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftoj gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.


**III.** Ky aktvendim në afat prej shtatë ditësh të shpallet në tabelën e shpalljes së gjykatës, të botohet në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe të botohet në njërin nga gazetat ditore të Kosovës apo sipas nevojës të shpallet në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme.

**IV.** Shpenzimet për përfaqësuesin e përkohshëm bien në barrë palës paditëse.

**A r s y e t i m**

Bajram Bajrami nga fshati Pantinë, Komuna e Vushtrisë me vendbanim në Mitrovicë të cilin sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson Av. Elvir Imeri nga Mitrovica, ka parashtruar padi kundër të paditurës si më lartë.

Gjykata duke u bazuar në të dhënat si në padi në bazë të cilave konstatohet se pala paditëse nuk posedon adresën e saktë të paditurës, dhe duke marrë për bazë faktin se e paditura nuk është me shtetësi kosovare, gjykata nuk mund të kërkojë shënime nga organet relevante vendore.



Gjykata fillimisht me date 17.01.2020 si përfaqësuese të përkohshëm i të paditurës, kishte caktuar av.Fuad Halitin, mirëpo në ndërkohë kjo gjykate është njoftuar se ky avokat nuk e ushtron profesionin e tij të avokatisë, prandaj i autorizuar i paditësit me parashtrime të datës 16.06.2020, ka kërkuar që të caktojë një tjetër përfaqësues të përkohshëm.

Prandaj, vendimin për përfaqësues të përkohshëm gjykata e mori duke u bazuar në deklarinimin e palës paditëse se i njëjti nuk ka adresë të saktë të palës së paditur, gjykata pas konsultimit me Odën e Avokatëve të Kosovës rreth emrit kujdestar për përfaqësues të përkohshëm të paditurës së cekur si më lartë: Lora Borisova Aleksandrova nga Republika e Bullgarisë tani me adresë të panjohur iu caktua përfaqësuesi i përkohshëm Av. Musa Damati nga radhët e avokatëve të rajonit të Mitrovicës.

Pas shqyrtimit të propozimit të autorizuarit të palës paditëse, gjykata vlerësoi se ky propozim për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm të paditurës së cekur më lartë është i bazuar pasi që janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore të parapara me nenin 79.3 pika a) të LPK-së, ndërsa për përfaqësues të përkohshëm pas konsultimit me Odën e Avokatëve të Kosovës lidhur me avokatin kujdestar me dt.17.06.2020 ka caktuar Av. Musa Damati nga Mitrovica.

Përfaqësuesi i përkohshëm në kuptim të nenit 82 të LPK-se, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor, të cilat i ushtron deri sa të paraqiten në gjykatë të paditurit apo përfaqësuesi me prokurë, respektivisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftoj gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

Nga se u tha më lartë konform nenit 79.3.1, nenit 82 si dhe nenit 387.1 të LPK-së vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
C.nr.1363/2019 me datë 17.06.2020

**GJYQTARI,**  
Naim Mehulli

*Naim Mehulli*

**UDHËZIM JURIDIK** – Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.



KOMPANIA UJESJELLESË RAJONAL SH.A.  
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.  
REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABDEVANJE D.D.  
**PRISHTINA**

**D P A**

Departamenti për punë administrative  
Department for administrative works

Prishtinë me 03.07.2020 | Nr. 1070

U.D. Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanisë Rajonale të Ujësjetjesit „Prishtina“ SH.A. – Prishtinë, në harmoni me nenin 16, pika 11 – 3.2 të Statutit të KUR “Prishtina” Sh.A., me datën 03.07.2020, merr vendim për shpallje publike:

**SHPALLJE PUBLIKE**  
**Për kryerjen e shërbimeve të veçanta në Kompani**

**1. Një (1) Kontabilist të çertifikuar.**

**I përgjigjet:** Menaxherit për Kontabilitet dhe Thesar, ZKF dhe KE-së.  
**Vendi i Punës:** Prishtinë.

**Paga:** Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve. 900.00 Euro

**Kohëzgjatja e kontratës:** Maksimalisht 30 ditë .

**Orari i punës:** I plotë.

**Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:**

Përgatitjen e pasqyrave financiare për vitin 2019, rishikimin e tyre, certifikimin dhe nënshkrimin e tyre.

**Kushtet :**

Për kryerjen e këtyre punëve, përveç kushteve të përgjithshme, kandidati duhet të ketë:

Përgatitjen Superiore Profesionale – Fakulteti ekonomik; - të jetë kontabilist i certifikuar-së; - të ketë së paku 5 vite përvojë pune në lëminë e kontabilitetit.

**Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:**

- diploma e përgatitjes profesionale;
- çertifikatat e kontabilistit
- kopja e letërnjoftimit;
- çertifikata e lindjes;
- vërtetimi i përvojës së punës;

**Procedura për aplikim:** Aplikacioni merret në Kompani ose në web-faqën e Kompanisë, të njëjtit i bashkëngjiten fotokopjet e dokumenteve personale dhe dokumentacioni tjetër të kërkuar sipas Shpalljes dhe dërgohen në adresën KRU „Prishtina“ sh.a. në Prishtinë, Rr. „Hazir Shala“ nr.4 në zyrën nr. 44, më së voni deri me datën **17.07.2020** në ora **16.00**.

KRU “PRISHTINA” SH.A.  
- U.D. Kryeshefi Ekzekutiv -

Rruga “Hazir Shala”nr.4., Prishtinë  
Tel + 381 38 54 12 11, +381 38 55 10 10  
Fax + 381 38 54 14 37

[www.kur-prishtina.com](http://www.kur-prishtina.com)

**Lume's Details**  
**Estetik & Depilim**

044 900 978 | 045 681 898  
Sallon Depilimi Lume's Details  
lumesdetails  
Mbresa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"



Pejë, 03.07.2020

Me bazë në nenin 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, UA nr. 07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës nr. 04/L-037, nenin 169, 170, 171, 172, 173, 174, të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë nr. 04-V-622, Rregulloren për të Ardhurat Personale të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë ref. nr. 1944/16, e dt. 05.10.2016, Rregulloren për Procedurat Përzgjedhëse Lidhur me Emërimin, Riemërimin dhe Avancimin e Personelit Akademik të Rregullt në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, nr. 754, dt. 01.04.2019, Senati i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, në mbledhjen e mbajtur me datë 30.06.2020, nxjerri vendim sipas të cilit:

**UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA" në Pejë  
shpall**

**KONKURS**

**për riemërimin/avancimin e personelit akademik të rregullt në UHZ**

**I. Konkursi për shpalljen e pozitave në vijim:**

**FAKULTETI I BIZNESIT**

**Mësimdhënës për lëndët – Gjuhë shqipe**

- Një mësimdhënës për Lëndët: Menaxhmenti i Institucioneve Financiare, Menaxhimi i Riskut, Tregjet dhe Institucionet Financiare, Menaxhimi i Riskut Financiar, Qeverisja e Korporatave;
- Një mësimdhënës për Lëndët: Teoritë Bashkëkohore të Organizimit, Etika në Biznes, Ndërmarrësia dhe Inovacionet, Sjellja Organizative dhe Kontrolli i Burimeve Njerëzore, Planifikimi dhe Auditimi i Burimeve Njerëzore;
- Një mësimdhënës për Lëndët: Metodatat Cilësore në Kërkim Shkencor, Metodatat dhe Teknikat Sasiore në Kërkim Shkencor, Biznesi Ndërkombëtarë, Bazat e Menaxhmentit, Menaxhimi Strategjik i Avancuar, Menaxhimi i Projekteve;
- Një mësimdhënës për Lëndët: Mjedisi i Biznesit, Menaxhimi i NVM-ve, Menaxhimi i Burimeve Njerëzore, Teoritë e Vendimmarrjes, Bashkimi dhe Blerjet e Bizneseve;
- Një mësimdhënës për lëndët: Kontabiliteti Menaxherial, Auditimi, Auditimi i Avancuar, Kontabiliteti i Kostos;
- Një mësimdhënës për lëndët: Ekonometria, Menaxhmenti Financiar, Vlerësimi i Riskut dhe Kontrolli i Korporatave, Investimet dhe Menaxhimi i Portofollit

**Gjuhë boshnjake**

- Një mësimdhënës për lëndët: Bazat e kontabilitetit, Bazat e Financave, Financat e korporatës, Metoda cilësore në kërkim shkencor, Menaxhimi i NMV-ve;

**FAKULTETI JURIDIK**

- Një mësimdhënës për lëndët: Kriminologji dhe Penologji, E Drejta Penale, E Drejta Penale Ndërkombëtare, E Drejta Ndërkombëtare Humanitare;
- Një mësimdhënës për lëndët: E Drejta Kushtetuese, E Drejta Kushtetuese Pozitive, E Drejta e Punës, E Drejta Sociale;

**FAKULTETI I MTHM – SË**

- Një mësimdhënës për lëndët: Hyrje në Ekonomi (MTHM), Marketingu (MTHM), Tregu Turistik (MTHM), Biznesi në Turizëm dhe Hotelieri (MTHM), Biznesi Hotelier (MTHM), Ekonomika Menaxheriale (FB);
- Një mësimdhënës për lëndët: Menaxhimi Cilësisë së Ujërave (Agro), Standardet Mjedisore (Agro), Trajtimi i Tokave dhe Mbetjeve (Agro), Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore (MTHM), Menaxhimi dhe Mbrojtja e Mjedisit (MTHM), Ekologji (MTHM);

**FAKULTETI I AGROBIZNESIT**

- Një mësimdhënës për lëndët: Bazat e Prodhimit Bimor, Teknologjia e Drithërave, Bimët Foragjere, Teknologjia e Kultivimit, Fitoteknia, Bazat Testuese Bimëve Bujqësore;

- Një mësimdhënës për lëndët: Mikrobiologjia Ushqimore dhe Higjiena (TU), Proceset Themelore në Teknologjinë Ushqimore (TU), Enzimologji Ushqimore (TU), Bioprodhimet (TU), Teknologjia për Përpunimit e Qumështit (TU), Ushqimi dhe të Ushqyerit e Njeriut (TU);
- Një mësimdhënës për lëndët: Fitopatologjia, Entomologjia, Mbrojtja e Bimëve, Barërat e Këqija, Bazat e Toksikologjisë, Fiziologjia e Bimëve;
- Një mësimdhënës për lëndët: Vlerësimi i Pasojave në Mjedisi (AA), Teknologjia e Pijeve Alkoolike dhe Venës (TU), Bazat e Transmetimit të Nxehtësisë, Masës dhe Lëvizjes në Industrinë Ushqimore (TU), Mbrojtja e Ushqimit (TU), Bazat e Metodës Instrumentale (TU), Teknologjia e Produkteve të Pjekjes (TU);
- Një mësimdhënës për lëndët: Bioteknologji Ushqimore, Teknologji e Përpunimit e Ujit të Pijshëm, Kontrolli dhe Sigurimi i Cilësisë në Industrinë Ushqimore, Mbrojtja e Prodhimeve Bimore, Teknologjia e Përpunimit të Mishit, Bioteknologjia dhe Mbrojtja e Ambientit;
- Një mësimdhënës për lëndët: Agrometeorologji, Bujqësia Organike, Kultivimi i Fidaneve në Fushë të Hapur, Plehrat dhe Plehrimi, Mjediset e Mbrojtura dhe Luftaria, Bazat e Përimtaris;
- Një asistent për lëndët: Industria ushqimore dhe Mjedisi I, II, Teknologjia për Përpunimin e Qumështit, Teknologjia e Përpunimit të Mishit, Proceset e Fermentimit, Enzimologji Ushqimore, Ushqimi dhe të Ushqyerit e Njeriut;

**FAKULTETI I ARTEVE**

- Një mësimdhënës për Lëndët: Piano Obligative I, II, III, IV, V, VI, Piano I, II, III, IV, V, VI, VII, VIII
- Një mësimdhënës për Lëndët: Klarinetë (Instrumenti Kryesor) I, II, III, IV, V, VI, VII, VIII, Klarinetë (Instrumenti i dytë) I, II, III, IV, Pedagogji e instrumentit I, II, Praktikë Koncertale I, II, III, IV.
- Një mësimdhënës për Lëndët: Flaut (instrumenti kryesor) I, II, III, IV, V, VI, VII, VIII, Pedagogji në instrumentet I, II, Flaut (Instrumenti i dytë) I, II, III, IV, Praktik koncertale I, II, III, IV
- Një mësimdhënës për Lëndët: Teori Muzike, Harmonia I, II, III, Harmoni Bashkëkohore, Këndimi Koral I, II, III, IV, V, VI.

**II. KUSHTET E PËRGJITHSHME**

- Riemërimi/avancimi i personelit akademik do të bëhet në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, dispozitat e Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, si dhe Rregulloren për Procedurat Përzgjedhëse Lidhur me Emërimin, Riemërimin dhe Avancimin e Personelit Akademik të Rregullt në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, nr. 754, dt. 01.04.2019.

**III. KUSHTET PËR APLIKIM:**

- Kandidatët të cilët aplikojnë për riemërim/avancim për mësimdhënës duhet t'i paraqesin këto dokumente: formularin e aplikimit, CV - in, vendimin për thirrjen e fundit nga UHZ, kontratën e punës valide më UHZ, dëshmitë për publikimet shkencore e profesionale në 4 vitet e fundit, si dhe informatat e tjera specifike shtesë, të cilat janë të rëndësishme për pozitën që aplikojnë. Kandidatët të cilët aplikojnë për avancim në thirrjen akademike Prof. Dr. duhet të sjellin dëshmi për mentorim të temave të masterit dhe doktoratës (kopja e noterizuar e vendimit për caktim në mentorim).
- Kandidatët të cilët aplikojnë për riemërim në pozitën e asistentit duhet t'i paraqesin këto dokumente: formularin e aplikimit, CV - in, vendimin e zgjedhjes së fundit nga UHZ, kontratën e punës valide më UHZ, vendimin për regjistrimin e studimeve të doktoratës (të noterizuar dhe përkthyer në gjuhën shqipe), si dhe si dhe informatat e tjera specifike shtesë, të cilat janë të rëndësishme për pozitën që aplikojnë.
- Kandidatët që kanë mbaruar studimet bachelor, master ose të doktoratës jashtë vendit, duhet të sjellin edhe dëshmi nga MASHT përkatësisht vendimin për nostrifikimin e diplomës përkatëse (të noterizuar), në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.
- Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga dita e shpalljes në web-faqen zyrtare të Universitetit dhe gazetë, respektivisht deri më 18.07.2020.
- Aplikacionet e plotësuar së bashku me kopjet e dëshmimeve të nevojshme sipas konkursit, duhet fillimisht të dorëzohen në formë elektronike në e-mail: [apliko.online@unhz.eu](mailto:apliko.online@unhz.eu) dhe pastaj në formë fizike në zyrën e protokollit në Rektorat nga ora 09:00-15:00. Aplikacionet e dërguara pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Ju lutem shkarkoni **këtu** formularin për aplikim si mësimdhënës dhe si asistent **këtu**.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në faqen e internetit në këtë adresë: <http://www.unhz.eu>



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITETI  
"HAXHI ZEKA"



Peć, 03.07.2020

Prema članu 8. Zakona o radu br. 03/L-212, Administrativne Uredbe br. 07/2017 o Regulisanju Postupaka konkursa u javnom sektoru, članu 26. Zakona o Visokom Obrazovanju na Kosovu br. 04 / L-037, članu 169, 170, 171, 172, 173, 174, Statuta Univerziteta "Haxhi Zeka" u Peći br. 04-V-622, Uredbi o ličnim prihodima Univerziteta "Haxhi Zeka" u Peći ref. br. 1944/16, dt. 05.10.2016., Uredbi o Postupcima Odabira u vezi sa Imenovanjem i Unapređenjem Redovnog Akademskog Osoblja na Univerzitetu "Haxhi Zeka" u Peći, br. 754, dt. 01.04.2019, Senat Univerziteta "Haxhi Zeka" u Peći je na sastanku održanom 30.06.2020. donio odluku prema kojoj:

UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" u Peć

objavljuje

KONKURS

Za imenovanje/unapređenje redovnog akademskog osoblja

I. Konkurs se objavljuje za sljedeće pozicije:

#### FAKULTET BIZNISA

1. Jedan predavač za predmete: Upravljanje finansijskim institucijama, Upravljanje rizikom, Tržište i finansijske institucije, Upravljanje finansijskim rizikom, Korporativno upravljanje;
2. Jedan predavač za predmete: Savremene teorije organizacije, Etika u biznisu, Preduzetništvo i Inovacije, Organizaciono ponašanje i kontrola ljudskih resursa, Planiranje i Revizija ljudskih resursa;
3. Jedan predavač za predmete: Kvalitativne metode u naučnom istraživanju, Metode i Kvantitativne tehnike u naučnom istraživanju, Međunarodni biznis, Osnovi menadžmenta, Unapređeni strateški menadžment, Upravljanje projektima;
4. Jedan predavač za predmete: Biznis okoliša, Menadžment MSP, Menadžment ljudskih resursa, Teorije odlučivanja, Kupovina i spajanje biznisa;
5. Jedan predavač za predmete: Upravljačko računovodstvo, Revizija, Napredna Revizija, Računovodstvo troškova;
6. Jedan predavač za predmete: Ekonometrija, Upravljanje Finansijama, Procjena rizika i Korporativna Kontrola, Investicija i Portfolio upravljanja;

#### Bosanski jezik

1. Jedan predavač za predmete: Osnovi Računovodstva, Osnovi Finansija, Korporativne Finansije, Kvalitativne Metode u Naučnom Istraživanju, Menadžment MSP.

#### PRAVNI FAKULTET

1. Jedan predavač za predmete: Kriminologija i penologija, Krivično pravo, Međunarodno krivično pravo, Međunarodno humanitarno pravo;
2. Jedan predavač za predmete: Ustavno pravo, Pozitivno ustavno pravo, Zakon o radu, Socijalno pravo;

#### FAKULTET ZA MENADŽMENT U TURIZMU, HOTELIJERSTVU I OKOLINI

1. Jedan predavač za predmete: Uvod u ekonomiju (MTHM), Marketing (MTHM), Turističko tržište (MTHM), Poslovanje u turizmu i hotelijerstvo (MTHM), Hotelski biznis (MTHM), Menadžerska ekonomika (FB);
2. Jedan predavač za predmete: Upravljanje kvalitetom vode (Agro), Ekološki standardi (Agro), Tretman zemljišta i otpada (Agro), Integrisano upravljanje vodenim resursima (MTHM), Upravljanje i zaštita okoliša (MTHM), Ekologija (MTHM);

#### FAKULTET AGROBIZNISA

1. Jedan predavač za predmete: Osnovi biljne proizvodnje, Tehnologija žitarica, Faringealne biljke, Tehnologija uzgoja, Fitotehnika, Osnove ispitivanja poljoprivrednih biljaka;
2. Jedan predavač za predmete: Mikrobiologija hrane i higijene (PT), Osnovni procesi u prehrambenoj tehnologiji (PT), Enzimologija hrane (PT), Bioprodukti (PT), Tehnologija prerade mlijeka (PT), Hrana i ishrana čovjeka (PT);
3. Jedan predavač za predmete: Fitopatologija, Entomologija, Zaštita biljaka, Štetno bilje, Osnove tehnologije, Fiziologija biljaka;
4. Jedan predavač za predmete: Procjena utjecaja na okoliš (AA), Tehnologija vina i alkoholnih pića (PT), Osnove prijenosa toplote, mase i kretanja u prehrambenoj industriji (PT), Zaštita hrane (PT), Osnove instrumentalne metode (PT), Tehnologija pečenja (PT);
5. Jedan predavač za predmete: Biocenologija hrane, Tehnologija prerade vode za piće, Kontrola kvaliteta i sigurnost u prehrambenoj industriji, Zaštita biljne proizvodnje, Tehnologija proizvodnje mesa, Biotehnologija i zaštita okoliša;
6. Jedan predavač za predmete: Agrometeorologija, Organska poljoprivreda, Uzgoj sadnica na otvorenom polju, đubriva i gnojiva, Zaštićeno okruženje i cvjećarstvo, Osnovi povrtlarstva;
7. Jedan asistent za predmete: Industrija okoliša I, II, Tehnologija prerade mlijeka, Tehnologija prerade mesa, Proces fermentacije, Enzimologija hrane, Hrana i ishrana čovjeka;

#### FAKULTET UMJETNOSTI

1. Jedan predavač za predmete: Obavezni-Klavir I, II, III, IV, VI, Klavir I, II, III, IV, V, VI
2. Jedan predavač za predmete: Klarineti (glavni instrument) I, II, III, IV, V, VI, VII, VIII, VIII, Klarineti (drugi instrument) I, II, III, IV, Pedagogija instrumenta I, II, Koncertna praksa I, II, III, IV;
3. Jedan predavač za predmete: Flauta (glavni instrument) I, II, III, IV, V, VI, VII, VIII, Pedagogija na instrumentima I, II, Flauta (drugi instrument) I, II, III, IV, Koncertna praksa I, II, III, IV;
4. Jedan predavač za predmete: Teorija muzike, Harmonija I, II, III, Savremena harmonija, Horno pjevanje I, II, III, IV, V, VI.

#### II. OPŠTI USLOVI

1. Izbor akademskog osoblja će se realizovati u skladu sa Zakonom Br. 04/L-037 za Visoko Obrazovanje u Republici Kosova, dispozicijama Statuta Univerziteta "Haxhi Zeka" u Peći, kao i Uredbom o Postupku Izboru koja se tiče Imenovanja, Ponovnog Imenovanja i Unapređenja redovnog akademskog osoblja na Univerzitetu "Haxhi Zeka" u Peći, br. 754, dt. 01.04.2019.

#### III. USLOVI PRIJAVE:

1. Kandidati koji se prijavljuju za imenovanje/unapređenje na poziciji predavača moraju dostaviti sljedeća dokumenta: Obrazac prijave, Biografiju, Odluku o posljednjem imenovanju na UHZ, Važeći ugovor o radu sa UHZ-om, Dokaz za znanstvene i stručne publikacije u posljednje 4 godine, kao i ostale dodatne informacije, koje su važne za poziciju na kojoj se prijavljuju. Kandidati koji se prijave za napredovanje u akademskom pozivu Prof. Dr. mora donijeti dokaze o mentorstvu magistrskim i doktorskim temama (ovjerena kopija odluke o imenovanju na mentorstvo).
2. Kandidati koji se prijavljuju za imenovanje na poziciji asistenta moraju dostaviti sljedeća dokumenta: Obrazac prijave, Biografiju, Odluku o posljednjem imenovanju na UHZ, Važeći ugovor o radu sa UHZ-om, Odluku o upisu doktorskih studija (verifikovanu i prevedenu na albanskom jeziku), kao i ostale dodatne informacije, koje su važne za poziciju na kojoj se prijavljuju.
3. Kandidati koji su završili osnovne, postdiplomske ili doktorske studije van zemlje treba da dostave i rješenje o verifikaciji diplome izdato od strane Ministarstva za Obrazovanje (overeno), Nauku i Tehnologiju, u suprotnom dosije kandidata će se smatrati nepotpunim.
4. Konkurs ostaje otvoren 15 (petnaest) dana od dana objave na službenoj web stranici Univerziteta i novinama, tačnije do 18.07.2020 godine.
5. Popunjene aplikacije zajedno sa neophodnim primjercima, prvenstveno se moraju dostaviti u elektronskoj verziji na e-poštu: [apliko.online@unhz.eu](mailto:apliko.online@unhz.eu) kao i u fizičkoj formi u uredu za protokol u Rektoratu od 09:00 – 15:00 časova. Dostavljene prijave, kao i prijave koje nisu kompletne, nakon isteka roka, neće se uzeti u obzir.

Molimo ovdje preuzmite prijavnicu kao nastavnik i kao pomoćnik. Konkurs možete naći i na web stranici: <http://www.unhz.eu>.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



**MEKA**  
HALAL FOOD

# PASHTETË PULE

gluten free



cilësi e garantuar

pa konservues